

Imzot Dodë Gjergji

**SHËRBEJMË ME PËRVUJTËRI
E
KUMTOJMË ME HARE**

Udhërrëfyes Baritor

2015 - 2020



Prishtinë, 2014

Seria e botimeve: “ZËRI I KISHËS”

2

Redaktor përgjegjës:
Don Fatmir Koliqi

Lektor:
Ndue Ukaj

© SH.B. DRITA, Prishtinë 2014.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Fotografia në kopertinë: *Procesioni në Vigjiljen e Festës
Të Ngriturit e Marisë Virgjës në Qiell, Letnicë 2014.*

Shtypi:
„SIPRINT“, Prizren

ISBN 978-9951-17-042-0

Seria e botimeve:

1. SEKRETARIATI PËR JO TË KRISHTERËT, *Shpresa që banon në ne. Pasqyrë e shkurtër e fesë katolike*, Drita, Prizren 2004.
2. IMZOT DODË GJERGJI, *Shërbejmë me përvujtëri e kumtojmë me hare. Udhërrëfytes baritor 2015-2020*, Drita, Prishtinë 2014.

SERIA E BOTIMEVE „ZËRI I KISHËS“ është seria e botimeve të Shtëpisë Botuese „DRITA“ që publikon libra, dokumente, studime, letra baritore, qarkore të Kishës Katolike Universale dhe lokale. Qëllimi i kësaj serie është njohja e lexuesit shqiptar me Mësimin e Kishës Katolike.

*Fort të dashur vëllezër meshtarë,
rregulltarë, rregulltare,
seminaristë, kandidate,
bashkëpunëtorë laik,
vëllezër e motra në pagëzim
dhe gjithë ju njerëz vullnetmirë.*

Po mbushen tetë vite qyshkur jam kthyer në mesin tuaj, si shërbëtor i Ungjillit dhe bari i grigjës së Kishës në Kosovë. Në ditën e intronizimit tim, në Katedralen e Zojës Ndhimëtare në Prizren, me kujdes dhe plot shpresë e shpalosa planin tim baritor, të përmbledhur në disa pika. Që në ditën e parë, dëshiroja të shprehja vullnetin tim për Kishën, në mënyrë që të bëja të qartë: çka doja prej kishës që e mora në dorëzim; ku doja ta çoja atë me dhuntitë dhe dëshirat baritore që kisha. Që atëherë e deri më sot, së bashku me ju, kemi bërë ecje, duke punuar me zell dhe dashuri në shërbim të

Ungjillit, në dobi të shpirtrave që na janë besuar dhe duke u përpjekur që të arrijmë të synuarën.

Duke e thelluar dashurinë e Kishës Nënë, jemi përpjekur, të shprehim kujdesin e nevojshëm për grigjën; ndaj me gëzimin atëror kemi pritur të gjithë, bijtë dhe bijat që janë kthye, dhe me kujdes të veçantë, jemi angazhuar që të kujdesemi për njeriun në nevojë. S'ka munguar bashkëndarja e përgjegjësive nëpërmjet delegimit të detyrave dhe përgjegjësive te personat dhe te komisionet e veçanta, madje s'ka munguar as përpjekja jonë për përparimin shpirtëror të secilit prej nesh.

Pas një përvoje pune të përbashkët, dhe pasi kemi arritur të jetësojmë shumëçka që kemi synuar gjatë viteve që shkuan, po vij para jush, me këtë udhërrëfyes baritor, me qëllim që çdonjëri prej jush, po edhe e gjithë grigja, të ketë në dorë një udhërrëfyes për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Ky plan baritor, mbi të gjitha, synon të jetë udhëzues për të gjithë ata që janë në shërbim të Ungjillit. Por, edhe për ata që kanë pozita udhëheqëse në strukturat që kemi konsoliduar: famullive, dekanateve, këshillave, komisioneve, zyrave të veçanta, por gjithashtu

edhe ndonjë segmenti tjetër që ndërlidhet apo bashkëvepron me këto struktura.

Unë pres që ky *Udhërrëfyes*, të jetë vërtet një mjet për të gjithë; për të planifikuar dhe vepruar së bashku gjatë shërbimit, i cili, duhet të na përforcojë në fe dhe dashuri, të na mbushë me gëzim e me shpresë, dhe të na shpie të gjithëve në mirësi dhe shenjtërim.

Ndaj, besoj shumë se kjo ecje e përbashkët në lutje dhe në meditim, do të na shton zellin baritor në pesëvjeçarim që na pret.

Bijë dhe bija fort të dashur,

Shpirtërisht dhe atërisht, ju grishi që të mos pushojmë duke e lutur Hyjin, Atin e Gjithëpushtetshëm, që nëpërmjet Birit të Tij, Zotit tonë Jezu Krishtit, dhe me fuqinë e Shpirtit të Tij të Shenjtë, të na bekojë me çdo bekim shpirtëror; të derdhë mbi ne çdo urti dhe kuptim, me anë të begatisë së hirit të Tij, në mënyrë që të mos na mungojë asnjëherë zelli shpirtëror, për ta zbatuar në jetët tona, Ungjillin e Tij. Prandaj, e lusim Zotin që të na ndihmojë t'i vejmë në jetë këto synime tona, të cilat, si bari juaj, po ju paraqes në këtë plan baritor.

I. KISHË NË PUNË DHE NË FALENDERIM

*“Po a nuk na ndizej zemra neve
ndërsa po bisedonte udhës me ne [...]?”¹*

1. Jam i bindur, se, përgjatë këtyre viteve, Jezusi na ka shoqëruar në gjitha hapat tanë, dhe asnjëherë s’na ka munguar shoqërimi i Tij. Njëkohësisht edhe ne jemi dëshmitarë të përpjekjeve tona për t’u bashkuar, në këtë udhëtim, me Kishën universale, sidomos nëpërmjet kremtimeve, takimeve, seminareve, konferencave, shtegtimeve dhe manifestimeve të përbashkëta, sikurse në nivelin e bashkësive tona famullitare ashtu edhe në nivelin e Kishës në Kosovë.

Kremtimi i *Vitit të Shën Palit (2008- 2009)*, ishte moment i bukur. Kudo ndër ne, shfaqej një ndjenjë entuziazmi, për lashtësinë e përkatësisë sonë kishtarë, duke u ndierë, *Kishë e themeluar prej apostujve* dhe

1 *Lk 24, 31*

*popull biblik*². Edhe sot e kam të freskët gëzimin e zemrave tuaja, kur shtegtonim së bashku drejt Kishës së Shën Palit në Gjakovë. A nuk ndizej zemra në flakë dashurie, kur shihnim se si besimtarët tanë na ndiqnin në këtë shtegtim, të shoqëruar me brohoritje, në këngë hareje e në uratë!?

2. *Viti i Nënë Terezës (2010)*, gjithashtu, ishte një mundësi e mirë për të vazhduar me këtë entuziazëm feste, dhe për të shtuar mundësitë tona për ungjillëzim. A s'na gëzohej zemra, deri sa kremtonim këtë vit hiri për Kishën tonë? Ndërsa, kulmi i këtij gëzimi ishte kur kremtuam 100 vjetorin e Lindjes të së Lumes Nënë Terezës. Në këtë kremtim, s'ishim vetëm besimtarë të krishterë e katolik, por ishim të bashkuar si komb, për të nderuar bijën më të madhe të popullit tonë, dhe për t'iu lutur kësaj të Lume për nevojat tona në Shenjtëroren që po ia ndërtojmë.

3. Kremtimi i *Vitit Meshtarak (2009-2010)*, dhe *Vitit të Fesë (2012-2013)*, ishin po ashtu dy dhurata, të cilat na i dhuroi pasardhësi i Shën Pjetrit, Ati i Shenjtë, Benedikti XVI. Këto dy përvoja hiri, na kanë ndihmuar të

2 Fjala përshëndetëse e Imzot Dodë Gjergjit në Simpoziumin Shkencor me rastin e Vitit të Shën Pallit (Prishtinë, 2009).

thellohemi në misterin e Kishës së Krishtit; në shugurimin tonë meshtarak; në bukurinë e jetës së kush-tuar. Feja jonë e shfaqur nëpërmes adhurimit dhe uratës, ka bërë që këto vite jubilarë t'i përjetojmë fuqishëm, dhe të shijojmë veprën shenjtëruese të Shpirtit Shenjt, në ne dhe nëpërmjet nesh.

4. Vitin që lamë pas (2013), për herë të parë, me besimtarë dhe barinj të trojeve tona, shteguam te varri i Shën Pjetrit. Është vështirë të përshkruhet ajo ndjenjë gëzimi dhe lumturie e besimtarëve tanë shqiptarë, që bashkoheshin në një manifestim të madh, me besimtarët e mbarë botës. Sa i madh ishte gëzimi i tyre, kur Papa vendosi t'i ulë ata *n'krye të vendit*,³ në Sheshin e Shën Pjetrit. E, deri sa ende ky gëzim është i plotë, Ati i Shenjtë Papa Françesku e rindezi këtë gëzim shumë më fuqishëm, kur nga Dritarja e Tij ia shpalli botës se dot ta vizitonte Shqipërinë: *“Me këtë shtegtim të shkurtër, dua të përforcoj në fe Kishën e Shqipërisë dhe t'i dëshmoj inkurajimin tim një vendi, që vuajti gjatë, si pasojë e ideologjive të së kaluarës.”*⁴ Përjetuam, po ashtu, edhe përqaftimin atëror, që ai na dhuroi në Tiranë, kur me dëshminë e dashurisë së tij, e nderoi popullin

3 Shprehje popullore

4 *Engjëlli i Tenzot*, Vatikan, 12. 08. 2014.

tonë dhe preki zemrën e secilit prej nesh. Ai na bekoj, duke na përshëndetë me fjalët e paqes: “*paqe në mes jush, paqe në shtëpitë tuaja, paqe në kombin tuaj*.”⁵

5. Këto që po i theksoj, janë vetëm ngjarjet e rëndësishme që e kanë nxitë në ne entuziazmin ungjillëzues, ndjenjën e falënderimit për hiret që na janë dhuruar, dhe shpërblimin që kemi marrë, për zellin tonë meshtarak, në shërbim të shpirttrave. Sigurisht, s’ka munguar as përpjekja jonë e përhershme për të madhëruar Hyjin, sikur janë: lutja e mesha e përditshme; takimet tona të përmuajshme; ushtrimet shpirtërore të përvjetshme; përmbyllja e përsheptërisë së majit në Shenjtëroren e Zojës në Letnicë; takimi i rinisë në vigjilje të së Dielës së Larit etj. Këto veprimtari, pa dyshim janë puna e palodhshme e secilit prej nesh me popullin e Zotit. E them me gjithë bindje, se, është Shpirti i Zotit ai që na ka përcjellë, duke na afruar në plotësi dashurinë e Bariut. Ai, po ashtu, na fton që me frymën e bashkëpunimit ndërmjet ipeshk-vit e meshtarëve, rregulltarëve e besimtarëve laik, që t’i japim hov të ri veprimtarisë sonë baritore e të vi-

5 *Predikimi i Papa Françeskut në Sheshin Nënë Tereza, Tiranë, 21 shtator 2014*

jojmë të kërkojmë forma të reja për ta bërë Kishën të pranishme në gjirin e shoqërisë sonë.⁶

Punëtorë të vyeshëm në vreshtin e Hyjit

6. Ecja jonë e përbashkët, gjatë këtyre viteve të shërbimit në Kosovë, ishte e tëra në dobi të shpalljes së Ungjillit, në shërbim të jetës sakramentale dhe në të mirën e drejtimit të Kishës nëpër shtigjet e kësaj kohe që po e jetojmë së bashku. Prandaj, është rast i mirë, që ta falënderojmë Zotin, për dhuratat e mëdha të cilat na i ka dhuruar, edhe nëpërmjet frytshmërisë së punës tonë, në vreshtin e Tij.

Kur e kthejmë shikimin mbrapa në vreshtin e punuar, sigurisht se “*na bahet zemra mal*”⁷, dhe ndjehemi pjesëtarë të hireve të trashëguara, fesë së dhuruar, dashurisë vepruese dhe shpresës që na nxitë drejt të nesërme me gëzim. Por, në anën tjetër, kur e hedhim shikimin para, e shohim një pjesë të vreshtit të Hyjit të papunuar, sidomos ato pjesë të braktisura që moti, e na kaplon një *dróe* shpirtërore.

6 Khs. *Predikimi i Papa Franceskut në Sheshin Nënë Tereza*, Tiranë, 21 shtator 2014

7 Shprehje popullore

O vëllezër! Mos kini frikë të sfidoheni nga Zoti, sepse Ai nuk na le të vetëm, ashtu sikurse s'na ka lanë as në të kaluarën. Prandaj, mos t'iu molisë puna që kemi përpara, vështirësitë e reja që na paraqitën e as mangësitë tona, me të cilat mund të përballemi; por me gëzimin për të arriturat dhe punën që kemi bërë, të jepemi pas atyre që na vë Zoti para nesh.

S'duhet të humbim kohë, por t'i përvishemi punës për t'ia shëruar plagët popullit tonë të shumëvujtur dhe për t'ia rinuar shpirtin fisnik që ka. *“Ogurin e kemi të mirë; të mos jetë pra kurrfarë vonese; as frika as droja të mos e mnerojë askë dhe të mos ndahemi prej një pune kaq të madhe.”*⁸ Kjo ecje e përbashkët, në shërbim të së ardhmes për Kishën e Krishtit, duhet të na entuziazmojë që të lumtur e të hareshëm të bartim barrën e punës sonë. *“Gëzohuni gjithmonë në Zotin, rishtas po ju them: gëzohuni!”*⁹

7. Po! Si mos të këndojmë *Hosana* e *Aleluja*, për gjithë ato motra dhe vëllezër që na u bashkuan në fe. Si mos të na entuziazmojë fati i dhuratës së pagëzimit që ju ndamë atyre, dhe për dëshminë që ata bëjnë sot në jetën e tyre të përditshme. Përveç tjerash, ata janë mi-

8 Kuvendi i Arbrit 1703, Prishtinë 2003, f. 381 .

9 *Fil 4, 4*

sionarë në familjet e tyre, në vendbanimet e tyre, dhe me butësi, guxim e përvujtëri, dëshmojnë fenë! Ndaj, si mos t'i këndojmë këngë falënderimi Zotit, për krijimin e kushteve të reja që të jemi në shërbim të shpirtave, për shërbesat tona kushtuar Zotit, nëpër shumë kisha të reja, veçanërisht për ato kisha në vendet prej ku ishte dëbuar që disa shekuj.

Mbi të gjitha duhet të falënderojmë Zotin për Shenjtëroren që do t'ia kushtojmë së Lumes Nënë Terezës. Mirëpo, edhe për shumë të mira tjera që Shpirti Shenjt po bënë nëpërmjet nesh. Në të vërtetë: “*Vetë Hyji i qiellit po na e prin të mbarën dhe ne jemi shërbëtorët e tij ...*”¹⁰

8. Si mos ta falënderojmë Zotin për kaq shumë meshtarë, rregulltarë e rregulltare, që i ka dhuruar kësaj grigje të vogël. Vazhdojmë ta falënderojmë Hyjin për çdo seminarist që e kemi në seminarin tonë të përbashkët në Shkodër. Nuk duhet të mungojë falënderimi për thirrjet rregulltare, për familjet e reja, për popullin e Zotit që na bashkohet për çdo të diele dhe festa nëpër kishat tona. Nuk duam të mungojë

10 *Neh 2, 20a*

falënderimi ynë edhe për ata që vetëm na respektojnë dhe na mbështesin.

Përveç se e falënderojmë Zotin për shërbesën e kultit hyjnor, për punën baritore dhe shërbimin kishtar që meshtarët tanë bëjnë në Kosovë, ne, po ashtu, e falënderojmë Hyjin, për punën që bëjnë meshtarët tanë në Shqipëri, si dhe në vende të ndryshme të botës, ku me zell të veçantë bëjnë kujdesin baritor nëpër misione tona, për besimtarët dhe besimtare tona, që janë larguar nga vendi i tyre. Ne me dashuri e përcjellim punën e meshtarëve dhe jetën e besimtarëve atje, sepse ata janë bijë dhe bija të kësaj kishë. Këndej edhe s'kursejnë asgjë për ta përkrahë kishën e tyre të origjinës, si me praninë e tyre në momentet më të rëndësishme të jetës së tyre sakramentale, po ashtu edhe me mjete financiare.

9. Edhe pse jo akoma mjaftueshëm, asnjëherë s'ka munguar angazhimi dhe zelli ynë i përvujtë, për të përgatit kishën tonë që t'iu përgjigjet sfidave të së tashmes sidomos dhe të marrë përgjegjësitë e reja për paqe në vend, pajtimin mes njerëzve, nxitjen e ekumenizmit me kishat tjera, ruajtjen e bashkëjetesës ndërfetare dhe kërkimin e rrugëve të dialogut me të gjithë.

*Ejani të shkojmë ku jemi thirrur
e të dërguar*

10. T'i besosh, t'i shërbesh, ta shpallësh dhe ta dëshmosh me jetë të Ringjallurin, është një impenjim i përditshëm; një nevojë e përhershme dhe një kërkesë e vazhdueshme. Në të vërtetë, është një mision, i cili, gjithnjë kërkon guxim për të ecur kundër stuhisë; durësë për të përballë vështirësitë e shumta, sakrificë me dashuri për të ruajtur fenë dhe entuziazëm i pashtershëm për ta mbajtur gjallë shpresën dhe për të ushtruar dashurinë.

I krishteri është i ftuar të jetë në lëvizje. Ai nuk mund të rrijë i gozhduar në të kaluarën, sepse i takon të Ringjallurit, i cili, e ka liruar nga prangat e gjitha llojeve; e ka shpëtuar nga vdekja dhe e fton që të shkojë me gëzim në Galile, për ta ritakuar Atë, mu aty ku gjithçka kishte filluar. Papa Françesku, duke komentuar ungjillin e Pashkëve, thoshte: “Duhet të kthehemi atje, (*në Gallile*, vër. ime), për ta parë Jezusin e Ringjallur që të bëhemi dëshmitarë të ringjalljes së Tij. Ky nuk është një kthim mbrapa, nuk është as një nostalgji. Është kthim te dashuria e parë, për të marrë

zjarrin që Jezusi e ka ndezur në botë, e për t'iu çuar të gjithëve, deri në skajin e botës.”¹¹

11. Me energjinë e zjarrit të dashurisë, iu kemi përgjigjur ftesës ungjillore, që të kthehemi te Galilea¹² jonë, *aty ku e kemi takuar për herë të parë Krishtin*: te Pagëzimi, te Shugurimi, te Kushtimi, atje ku e kemi ndezur “*gacën*” e zemrës sonë, në këtë zjarr dashurie, që Krishti e ka ndezur në Kishë. Kërkesa e Krishtit “*shkoni*”, është kërkesë e përhershme: Ai na dërgon tek të gjithë njerëzit, që t’ju themi se Mbretëria e Hyjit është afër¹³, na dërgon te çdo shtëpi që t’ua çojmë paqen¹⁴, na dërgon te delet e humbura¹⁵, na dërgon para vetës, nëpër qytete e fshatra¹⁶ e na nisë në çdo skaj të botës që të pagëzojmë njerëzit në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.¹⁷ Ai kërkon prej nesh t’ia bëjmë gati Darkën e Pashkëve.¹⁸ Të gjithë jemi të

11 *Homilia e Atit të Shenjtë Françeskut. Vigjilja e Pashkëve në Natën e Shenjtë*, e shtunë, 30 mars 2013.

12 Khs. *Mk 16, 16*.

13 Khs. *Mt 10, 7*.

14 Khs. *Lk 10, 1-10*.

15 Khs. *Mt 10, 6*.

16 Khs. *Lk 10, 1*.

17 Khs. *Mt 28, 16-20; Lk 24, 36-49; Gjn 20, 19-23; Vap 1, 6-8*

18 Khs. *Mt 26, 18*.

thirrur dhe të dërguar; këndeje secili që është thirrur në pagëzim, kushtim apo shugurim, s'mund të jetë i pa angazhuar, sepse dëgjon pa ndërprerë pëshpëritjen e Krishtit: *"Shkoni edhe ju në vreshtin tim e do t'ju jap sa të jetë e drejtë."*¹⁹

12. Kisha jonë është një vresht i kamotshëm, të cilën e ka mbjell Zotëria. Ajo është bashkudhëtare e Historinë sonë që nga koha e apostujve. Ajo gjithnjë iu është përgjigjur ftesës ungjillore për të ecur në këtë shtegtim misionarik, dhe nëpërmjet sakrificës së bijve dhe bijave të veta, ka arritur të mbaj ndezur flakadainin e dashurisë, që Krishti e kishte ndezur në botë, në zemrën e njeriut tonë. Grigja e Hyjit, që jeton sot në Kosovë, në bashkështegtim me kishën e përgjithshme, ka lënë gjurmë të pashlyeshme të dëshmisë, besnikërisë dhe të shenjtërisë. Ndaj, s'mund të mos e kujtojmë dëshminë e shenjtërve martirë, besnikërinë e popullit të prirë nga Gjergj Kastrioti, e deri në kohën tonë, dashurinë shenjëtruese të Lumes Nënë Terezës.

Afërsisht para një dekade, Hyji deshi që unë të bëhesha bari i kësaj grigje, i kësaj Kise të lashtë dhe të vuajtur. Jam përpyetur me gjithë zemër, së bashku

¹⁹ Mt 20, 4.

me ju, të shërbejmë me përvujtëri, të kumtojmë me hov Lajmin e Mirë, duke e dëshmuar dhe adhuruar atë. Akoma janë të freskëta kujtimet e mia se si, gjatë vizitës baritore e përjetonim njëri-tjetrin në lutje, në dëshmi dhe në përgjegjësi. Shpresoj shumë që edhe ju e keni përjetuar dashurinë, afërsinë dhe kujdesin e ipeshkvit tuaj.

13. Tani po përgatitemi të vazhdojmë ecjen tonë, atje ku Krishti na thërret, në të nesërmen plotë shpresë, që të mund të ecim të sigurt në shtegtimin tonë drejt zbatimit të vullnetit hyjnor, me jetët tona, në Kishën e Hyjit në Kosovë. Po ju ofroj këtë plan baritor, si një udhërrëfyes në kërkim të vullnetit të Atit, sikurse një “breg”²⁰ prej ku do e vëzhgojmë, dhe prej ku do ta shpallim kumtin e Krishtit, si dhe mësimin e Kishës së Tij.

Vëllezër e motra fort të dashur, derisa grishemi me këtë vullnet të bariut, mos të pushojmë kurrë duke i vëzhguar sugjerimet e Shpirtit Shenjt “sepse bijtë e Hyjit janë ata, të cilët i udhëheq Shpirti i Hyjit.”²¹

20 Khs. *Mt 5, 1-11*

21 *Rom 8, 14.*

II. FRYTET E UNGJILLËZIMIT NDËR NE

Sakrifica me dashuri ishte zëri i Fjalës

14. Që prej kohës Apostolike, vazhdimisht është fol Fjala e Zotit në popullin tonë. Ajo vazhdon të jetë e gjallë e *t'i nihet zani* edhe sot ndër ne dhe të predikohet prej nesh. Lashtësia e pranisë së Kishës; kontributi që kisha i ka dhanë të kaluarës së popullit tonë; përvoja e gjatë e vuajtjes dhe martirizimi i shpeshtë, kanë bërë që kisha ndër ne të jetë më shumë një dritëz në *“shekullin plot me lot”*²², se sa një *pishtarë mbi magje, që shndritë gjithë shtëpinë*.²³ Të parët tanë shpeshherë janë detyruar të heshtin, mirëpo, në këtë heshtje, ata përqaftuan sakrificën, e cila gjithnjë kushtohej me dashuri për *“Atmé e fe”*.²⁴ Kjo heshtje, në përqaftim të

22 Pjesë e lutjes së vjetër *“Të falem, Mbretnesha”*, versioni gegnisht.

23 Khs. *Lk 11, 33*

24 *Atdhe e fe*. Binomi i meshtarëve shqiptarë gjatë shekujve. Është shprehje karakteristike që e ka shenjua gjithë veprimtarinë e jetës së tyre.

sakrificës, u bë britmë e madhe dashurie, dhe dëshmi e gjallë për të parët tanë. Po edhe këndej e tutje, do të jetë frymëzim për ne e për të gjithë breznitë e ardhshme.

Kisha dhe të krishterët, edhe pse ishin të privuar nga mundësitë, edhe pse i kishin të mohuara të gjitha të drejtat, edhe pse ishin të dëbuar nga qendrat urbane, edhe pse ishte e ndaluara me ligj, megjithatë, ajo, bashkë me ata që i mbetën besnik pagëzimit, arriti të jetë frymëzim i fesë, të mbajë gjallë shpresën, e njëkohësisht të shndërrohet në gurrë të pashterrshme dashurie ndërvëllazërore.

Britma e gjakut të martirëve, sakrifica dhe djersa shumëshekullore e barinjve, ishin vetvetiu, predikimi i zëshëm i Ungjillit, dhe zë i fuqishëm i Fjalës së Zotit, në kohërat kur na morën fjalën dhe na detyruan të heshtnim me çdo kusht.

15. Edhe në rrafshin identitar, Kisha Katolike në përgjithësi dhe prelatët e saj në veçanti, kanë qenë dritë e vetme e në të kaluarën tonë të robëruar, dritë kjo që na ka ndihmuar të dalim nga periudhat e errëta të historisë. Nën ndriçimin e kësaj drite, të parët tanë, kanë arritur ta kenë identitetin etnik e kulturor, të ruajnë gjuhën e ëmbël shqipe, dhe ta zhvillojnë atë duke

e shndërruar në gjuhë të predikimit, të pagëzimit, të këngës dhe të vajit. Gjuhë, e cila fillon historinë e vetë të shkrimit “Vente’ paghesont premenit Atit et Birit et Spertit Senit”²⁵ (*Unë po të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt*), e në të cilën “... nanat tona, shi prej djepit na kanë thânun, se asht një Zot, qi do ta dona; njatë, qi jetën na ka dhânun.”²⁶

16. Ne, s’mund të themi se të parët tanë arritën ta ruajnë fenë, sepse realiteti na dëshmon se një pjesë e popullit tonë, nën trysnitë e shekujve paskastriotian, e humbi besimin dhe hoqi dorë nga feja e të parëve, për t’u konvertuar në islam. Mirëpo, me sakrificë e mund, kanë ruajtur “*farën*”. Kjo jemi ne. Kjo farë, tani duhet të rimbillet në zemrat vullnetmira të njerëzve të kohës sonë, në mënyrë që gëzimi ungjillor t’i ri-lumturojë zemrat e njerëzve tanë edhe dashuria e mohuar t’i rinjomë shpirtrat e tyre.

25 Imzot Pal Engjëlli, *Formula e Pagëzimit*, 1462.

26 At Gjergj Fishta, *Gjuha Shqipe*, Vepra I, Botimet Fishta, Lezhë 2012, f. 8.

*“Me Jezu Krishtin gjithmonë lindë
dhe rilindë gëzimi”²⁷*

17. Realiteti i ri në të cilin jetojmë dhe mundësitë e reja që na ofrohen, duhet t'i përdorim në shërbim të Ungjillit, në mënyrë që “Gëzimi i ungjillit mbush zemrën dhe tërë jetën e atyre që takohen me Jezusin. Ata që lëshohen në shëlbimin e Tij, çlirohen nga mëkati, trishtimi, zbrazëtia e brendshme dhe vetmia. Me Jezu Krishtin gjithmonë lindë dhe rilindë gëzimi”²⁸. Me këto fjalë të Papa Françeskut, i ftoi, meshtarët, rregulltarët e rregulltaret dhe të gjithë besimtarët, që të fillojmë një periudhë të re të ungjillëzimit; të ungjillëzimit të ri, në mënyrë që t'i ndihmojmë besimtarët tanë të thellohen më shumë në fe. Ne duhet t'i përcjellim ata dhe t'iu ndihmojmë atyre që të jenë të krishterë të vërtetë dhe me jetën e tyre të bëhen ungjillëzues në botën e sotme. Përveç ungjillëzimit të ri, misioni i Kishës dhe i të pagëzuarve sot, është misioni i riungjillëzimit. Kërkohet që secili prej nesh të vihet në shërbim ungjillëzues në mënyrë që, kushdo që e kërkon Krish-

27 Papa Françesku, *Nxitja apostolike* Evangelii Gaudiun (Gëzimi i ungjillit), n. 1, Ylber, Tiranë 2014. (në vazhdim EG)

28 EG, n. 1.

tin, nëpërmjet pagëzimit, ta gjejë atë të pranishëm në dëshminë e jetës sonë.

18. Ungjillëzimi i ri është një përpjekje e Kishës së përgjithshme, e cila angazhohet t'i rihapë portat e dashurisë ndaj të gjithë njerëzve, me një qasje të re ndaj gjeneratave të sotme, për t'i afruar pranë Krishtit, duke i miqësuar me Ungjillin nëpërmjet Kishës. Ishte Papa i Shenjtë Gjon Pali II, ai i cili, për herë të parë e ftoi Kishën që të kërkojë mënyrat e ungjillëzimit të ri. Edhe Papa Benedikti XVI, e ka nxitë kishën që t'i përvishet angazhimit me zell të ri baritor për të dialoguar me gjithë njerëzit, *me t'folmen* që është e kuptueshme për njeriun e sotëm. Nëpërmjet ungjillëzimit të ri e gjithë Kisha dëshiron të bashkëbisedojë me njeriun e sotëm mbi mangësitë e së përkohshmes, dhe mbi vlerat e transhedentes, duke e nxitë një *dialog të sinqertë mes fesë dhe arsyes* (fides et ratio) dhe një bashkëpunim vëllazëror për të mirën e përbashkët me të gjithë.

Ungjillëzimi i ri, s'është projekt apo një strategji e Kishës për t'ia mbushë mendjen njeriut të sotëm, por një frymë e re dashurie, që Shpirti i Shenjtë e ka *hukatë* në Kishën e Krishtit, që ka për qëllim ta përkrahë njeriun e ngulfatur, tashmë, nga relativizmi, hedonizmi, konsumizmi, vetjakësia, relativizmi, dhe prej shumë

të këqijave të tjera, që po e gjymtojnë shpirtin fisnik të tij. Kisha, me krejt gjymtyrët e saja, është e ftuar të ndërmjetësojë takimin e ri, mes njeriut të sotëm dhe Krishtit, me qëllim që njerëzit e kohëve tona të rigjejnë gëzimin dhe lumturinë ungjillore, duke e ripërtërirë miqësinë e tyre me Krishtin Shpëtimtar.

19. Kësaj përpjekjeje, duhet t'i bashkohemi edhe ne, sepse po shohim si kjo valë, *e kulturës së jetës pa vlera*, po na afrohet dita ditës dhe po rrëmben realitetin tonë, shoqërinë, por edhe kishën.

Ungjillëzimi i ri, është i nevojshëm e dobishëm edhe për njeriun tonë besimtar, të cilin, duhet ndihmuar që të kalojë nga feja e tij e traditës, në thellësinë e besimit të tij, duke ia mundësuar takimin personal me Krishtin. Mbi të gjitha, ungjillëzimi i ri, është një *ftesë për kthim*. Kjo ftesë vlen për të gjithë: për të pagëzuarit, për të shuguruarit, për të kushtuarit, si dhe për veprimtarët e tjerë që punojnë në shërbim të Ungjillit, me qëllim që të kthehen nga *vetja* te Krishti. Rikthimi te i Ringjalluri, është rikthim në entuziazmin e Rrëshajve, te guximi Apostolik për të shpallur dhe për të dëshmuar.

*Ta bartim gëzimin ungjillor
tek të gjithë njerëzit*

20. Përveç që i bashkohemi nevojës së përgjithshme të ungjillëzimit të ri, kisha jonë ka nevojë të hapet edhe ndaj bijve të vetë të dikurshëm, që janë larguar qëmoti prej saj. Është më se e domosdoshme që t'iu ofrojmë dashurinë e *“Atit të mirë”*, të gjithë atyre që kërkojnë të kthehen në *shtëpinë e tyre të vjetër*.

21. Kudo, nëpër famullitë dhe bashkësitë tona, lypset të jemi të hapur ndaj vëllezërve dhe motrave që, me zemrën dhe me mendjen tyre, janë duke e kërkuar Krishtin apo veç janë nisë për ta gjetë atë te Kisha jonë. Ju përsëris edhe njëherë atë që ju thashë të Enjten e Madhe: *“rrini zgjuar në uratë dhe vëzhgoni kur një zemër e tillë do të trokasë në derën e shtëpisë famullitare apo në portën e zemrës tuaj, për të kërkuar Krishtin, dashurinë e Tij dhe pagëzimin. Pritni me gëzimin ungjillor këto zemra, hapeni me dashuri derën e Kishës për ta dhe duani me gjithë Zemër.”*²⁹

29 Imzot Dodë Gjergji, *Homelia në meshën e shukurimit të vavrave të shenjtë*, Prizren 2013 (dorëshkrim).

Puna me katekumenë, aq sa është e shenjtë aq është edhe e vështirë, sepse kërkon shumë përvujtëri, shumë thjeshtësi, e mbi të gjitha, kërkon guxim e fesë, duruesën e shpresës dhe qëndrueshmërinë e dashurisë. Mos u dekurajoni kur e shihni pasigurinë e tyre, mos u lodhni duke i pritur me dashuri sa herë që provojnë të marrin hapin përfundimtar të kapërcimit. Aq më tepër, nëpërmjet dashurisë së durueshme që ne e dëshmojmë para tyre, ata duhet ta njohin Zemrën e Zotit, që i pret, i do dhe është e gatshme t'i mbushë me hire.

Për një gjë duhet të jemi të sigurt të gjithë, se këto bija dhe bijë, që vinë te ne si “*lypsa t’Zotit*”, na shikojnë me të njëjtin sy sikur e shikon lypësi i uritur të pasurin. Ai nuk e kërkon poseduesin e pasurisë, por bukën që ai ka, sepse ia shuan urinë atij.

Ju them me bindje, këta njerëz s’janë të interesuar të dëgjojnë çfarë ne dimë, por duan të dinë çka ne besojmë. Ata s’duan që ne t’ju mbajmë leksione për Zotin, por duan ta shohin Zotin të pranishëm në jetët tona dhe në Kishën e Krishtit. Ata s’duan t’iu shpjegojmë mbi dashurinë e krishterë, por duan të “ngjyejnë” zemrën e vet në dashurinë që mbartë zemra jonë.

22. Kudo që përpushim në vatrën e shpirtit të njeriut tonë, gjejmë gacën e ndezur të fesë së t'parëve. Këndeje, zemërbutë, me duresë e përvujtëri, t'i pranohet të gjithë. Dhe me zjarrin e *gacës që ka ruajtur*, ta rindezim fenë e të parëve në zemrat e tyre nëpërmjet ecjes katekumenale. Gjatë kësaj ecje dhe shqyrtimi, ata nevojitet që t'i miqësojmë me Krishtin, t'i njoftojmë me fenë biblike; me mësimin e Ungjillit. T'i ndihmojmë që të thellohen në besimin e Kishës, të sprovonjë përvojën e shenjtërve, të ushtrojnë bujarinë e dashurisë, të shijojnë mëshirën e Zotit, të gjejnë lumturinë në shpresën e të ngjallurit, dhe në ushtrimin e dashurisë ndaj të afërmit. Të arrijnë të zbulojnë kuptimin e sakrificës, gëzimin e jetës dhe lumturinë e t'bijve të Hyjit. Ndaj, duhet t'i ndihmojmë ata, që të meditojnë Fjalën e Hyjit, të jetojnë hirin sakramental, dhe të shpresojnë në mëshirën e Zotit. Ata asnjëherë s'duhet të ndihen të braktisur, por të pranuar me dashuri, nga gjithë anëtarët e bashkësisë së krishterë.

Është përgjegjësi e tyre e përhershme që të jetojnë atë që e kanë pranuar me pagëzim dhe ta dëshmojnë me guxim fenë. Duke e dëshmuar të vërtetën e zbuluar dhe duke jetuar në paqe, në harmoni me dhuratat që i kanë marrë.

23. Është më se e saktë, se, ju të pagëzuarit e ri, keni shumë vështirësi, për t'i qëndruar besnik pagëzimit tuaj. Ju duhet shumë duresë dhe sakrificë për të jetuar fenë, pasi që shpeshherë ju braktisin familjarët, të afërmit dhe miqtë tuaj të dikurshëm që i keni dashur dhe vazhdoni t'i doni. Jetoni larg bashkësive të krishtera, dhe keni kushte të vështira ekonomike për të udhëtuar. Mund t'iu përbuzin ose edhe ju kërcënojnë. Por, ju e keni zgjedhur Krishtin që duron; ju keni zgjedhur kryqin që shkakton dhimbje; ju keni zgjedhur dashurinë që falë, ju keni zgjedhur gëzimin që buron nga brenda zemrës, gëzim ky që s'mund të shuhet nga vendimet jashtë nesh. Këndej, është detyrë edhe përgjegjësi e juaja që të qëndroni me duresë, të dëshmoni me dashuri, bashkë me njerëzit tuaj derisa ta kuptojnë dhe të besojnë, se, që kur jeni pagëzuar, dashuria juaj për ta është më e madhe se ç'ishte. Se ju jeni më të mirë, më të ndershëm, më të sjellshëm, më zemërgjerë, më të ngadalshëm në zemërim dhe me të shpejtë në falje e pajtim. Me një fjalë: të gjithë ata që ju kanë njohur më parë, duhet të shohin të vërtetën dhe të lakmojnë bukurinë e shpirtit tuaj dhe ta përqafojnë Krishtin.

24. Të nxitur dhe të shtyrë nga dashuria, duhet t'i përdorim të gjitha mundësitë, brenda të drejtave tona, që na i dhuron paqja dhe liria e kohës në të cilën jetojmë, që të rizgjojmë zellin dhe entuziazmin ungjillëzues. Në mënyrë që të zgjohemi nga përgjumja e së kaluarës, si dhe të dalim nga plogështia e të sotmes, me nxitjen e Krishtit që na fton: Ti, hedhim edhe njëherë rrjetat³⁰! Të mbjellim edhe njëherë farën!³¹ Ta themi edhe njëherë Fjalën!

25. Si në kontekstin e ungjillëzimit të ri, ashtu edhe në atë të riungjillëzimit, duhet të na nxitë dashuria e Krishtit dhe Shpirti Shenjt që na u dhurua. Sepse, si dikur, ashtu edhe sot, jemi të dërguar rrugëve të fshatrave dhe qyteteve tona, për t'iu shpallë Lajmin e Mirë të gjithë njerëzve mbi tokë.³² Krishti, me dashurinë e tij, tërheq te vetja njerëzit e çdo kohe, bijtë e çdo gjenerate dhe ia bashkon ata Kishës së vetë, që ajo t'iu besojë shpalljen e Ungjillit. Gjatë zbulimit të përditshëm të dhuratës së fesë, gjejnë gëzimin e bijve të Hyjit, dhe entuziazmin e dëshmisë së Ungjillit.

30 Khs. *Mt 5, 5*.

31 Khs. *Mt 13, 4-24*.

32 Khs. *Mt 28, 19*.

III. KISHË QË E PRINË SHPIRTI SHENJT

*“Rrini zgjuar dhe lutuni të mos bini
në tundim”³³*

26. Epiqendra e veprimit dhe e misionit tonë, është kremtimi i meshës, adhurimi, meditimi, lutja e liturgjisë së orëve, lutja personale, por edhe i gjithë kulti hyjnor. Lutja me përrshpirtëri dhe shërbesa hyjnore me përvujtëri na rifreskon, na rimbushë, na përtërinë dhe na aftëson t’i rizbulojmë dhuntitë e Shpirtit Shenjt. Prandaj, me afsh të zemrës, i ftoj të gjithë besimtarët që ta rikthejnë uratën në shtëpitë e tyre, sepse aty ku është urata, aty vepron hiri. Mbi të gjitha, i ftoj meshtarët, rregulltarët e rregulltaret dhe seminaristët, që nëpërmjet lutjes së përditshme, vetë dhe me popullin e Zotit, t’i japin pa ndërpre lavdi Hyjit. Në uratë, duhet të ndjekim shembullin e Jezusit, që tërhiqej në vetmi për t’u lutur; shembullin e Apostujve që bash-

33 Mk 14, 38a.

koheshin me Marinë, Nënëen e Zotit, për t'u lutur, dhe shembullin e Shenjtërve, në mënyrë që urata të jetë kënga e gëzimit tonë. Urata, pra, duhet të jetë, *britma e shpirtit*, që e kërkon dhe e dëshmon praninë e Zotit.

27. Është më se e nevojshme që të përgatitim mirë takimet tona të përmuajshme, përtëritjet e përbashkëta, dhe ushtrimet shpirtërore të parvjetshme. Pse jo! Të iniciojmë edhe momente të ngjashme, lutjeje të përbashkëta, në famulli dhe në dekanate, me të ri, me grupet e katekizmit, me të sëmurit, me të moshuarit e ndonjë grup tjetër i pranishëm në bashkësi. Lutja së bashku, përveç që na garanton praninë e Jezusit Zot, ajo na mundëson të zbulojmë dhuratat e hirit që na janë dhuruar. Urata e përbashkët, na mundëson, po ashtu, t'ia njohim njëri-tjetrit bukurinë e shpirtit, t'ia shuajmë trishtimin e zemrës, dhe së bashku, ta përtërijmë gëzimin e shpresës.

28. Kur mungon lutja, atëherë sigurisht që s'i përngjajmë më Krishtit, por botës. Kjo gjendje, na verbon dhe nxjerr në pah plagët e mëkatit dhe të ligështive. E rrjedhimisht, na çon të merremi me mangësitë dhe paaftësitë e njëri-tjetrit.

Duhet ta bëjmë lutjen epiqendër të jetës sonë që të mos biem preh e verbimit shpirtëror. Sidomos, s'duhet të mungojë zelli ynë, që t'i bashkojmë besimtarët në lutjet e rëndomta, rruzaren e Zojes, litanitë e ndryshme, meditimin e udhës së kryqit dhe përsipirititë e tjera. Është më se e dobishme që të nxitën besimtarët e besimtarët të bashkohen në grupe të veçanta lutjeje, me qëllim që ta begatojnë urtën e Kishës sonë me forma të reja lutjeje. Vetëm kështu, do të arrijmë të jemi *Kishë në Lutje*.

Si bari, s'do të praj duke iu lutur Shpirtit Shenjt dhe Virgjërës Mari, që urata e Kishës dhe lutjet tuaja personale, të shndërrohen në burim hiri për ne dhe besimtarët, në mënyrë që dhuntitë dhe hiret të ndezin flakë karizmat në jetën e besimtarëve dhe bashkësive tona famullitare.

Të frymëzuar nga Shkrimi i Shenjtë

29. Bibla s'duhet të mungojë kurrë në duart tona. Tekstet biblike janë ndihmesa më e madhe në lutje. Ato na ndihmojnë të kundrojmë veprën krijuese të Hyjit me urtinë e etërve, na mësojnë t'i lutemi Zotit me shpirtin e shpresës profetike; na nxitë të shpërthejmë në

këngë lavdi; na zbulon misterin e Fjalës së Mishëruar. Nëpërmjet ungjilltarëve; na mëson me përvojën e lutjes së Krishtit dhe na nxitë me veprën ungjillzuese të Apostujve. Duke kuptuar historinë e shëlbimit, nëpërmjet fesë biblike, ne arrijmë t'ia nënshtrojmë Zotit, inteligjencën dhe vullnetin tonë, dhe njëkohësisht të kuptojmë me fuqinë e dashurisë hyjnore misterin e shëlbimit.

30. Çdo gjë duhet të fillojë me lutje. Sepse lutja duhet të jetë shtytësja kryesore që na nxitë drejt kthimit, që na dërgon te mëshira e Zotit, te gëzimi ungjillor, që na mban në shpresë. Në uratë, mund të dëgjojmë qartësisht zërin e Krishtit, i cili na thërret dhe na dërgon. Këndeje, çdo vepër e jona në shërbim të Fjalës; çdo shërbesë e jona në jetën sakramentale të Kishës, por dhe vepër në dobi të administrimit të punës tonë, pra çdo zell baritor, duhet të burojë si frymëzim i Shkriimit të Shenjtë e si fryt i uratës sonë.

Mbi të gjitha, e ftoj tërë Kishën të lutet për mua, bariun e saj, në mënyrë që unë, shërbëtori i padenjë, shenjtërisht t'iu paraqes në lutjet e mia para Atij, që më ka shuguruar dhe më ka dërguar të kujdesëm për ju, grigjë e vogël, dhe t'iu përfaqësoj denjësisht para botës.

*Të zbresim pak më poshtë
që të ngjitemi pak më lartë*

31. Jemi në kapërcyellin e *gjendjeve*, jemi në kohën e kalimit nga një e kaluar e errët në një të ardhme që jep shpresë. Besimtari nuk është më natyral, me vetë lindjen në familje katolike, por varet tërësisht nga përcaktimi personal, nga konteksti shoqëror ku jeton dhe nga gjendja familjare ku e shkruan historinë e jetës së tij. Kjo do të thotë që ne nuk mund të vetmjaftohemi, duke menduar se, është mjaft ajo që jemi duke bërë, që mjafton mënyra në të cilën jemi duke ungjillëzuar ose forma në të cilën jemi duke e mbarështuar punën tonë. Jo, nuk mjafton, aq më tepër kërkohet që të rrisim cilësinë e punës tonë në çdo fushë, në mënyrë që të jemi më të frytshëm dhe më të dobishëm.

Prandaj s' duhet humbur kohë, duke bindur njëritjetrin që ne dimë që jemi mirë, që jemi duke bërë mjaft. Por lypet t'i përvishemi punës për të ndihmuar njëritjetrin që të *zbresim pak më poshtë*, te realiteti i jetës së njerëzve, për të mësuar gjuhën që kupton njeriu i sotëm dhe, për të prekë, me zemër e me dorë, nevojat e tija. Mu nga *atje poshtë*, duhet t'i ndihmojmë ata që vijnë nga tradita e fesë, të thellohen në porosinë e

Ungjillit, në magjisterin e Kishës, në misterin e Sakramenteve, në dhuratën shërbimit dhe në bukurinë e shërbesës. Kjo *zbritje e jona më poshtë* na mundëson neve dhe besimtarëve të *ngjitemi më lart* në përgjegjësitë që burojnë nga pagëzimi, në përgjegjësinë e të shuguruarve dhe të kushtuarve, për të arritur lartësinë e shenjtërimit. Kështu, duke zbritur në thjeshtësi, përvujtëri dhe shërbim dhe duke u ngritë në të përkryeshmen, në drejtësi dhe në shenjtërim; arrijmë ta dëshmojmë njeriun e lumtur, lajmëtarin plotë gëzim, shërbëtorin plotë shpresë, të krishterin plotë zell dhe njeriun plot jetë.

Për të zbritur te këto *“thellësi”* dhe *“për t’u ngritë* në këto *“lartësi”*”, është e rëndësishme të jemi të bashkuar në dashuri e të kemi të njëjtin qëllim, të bashkuar kler dhe laik, dorë për dorë dhe shpirt për shpirti, si vëllezërit e motrat të të njëjtës fe, ashtu si na porosit Apostulli i Popujve: *“Kështu edhe ju, pasi dëshironi me gjithë zemër t’i keni dhuratat e Shpirtit Shenjt, bëni çmos t’i keni me begati, për edukimin e Kishës”*.³⁴

34 *1 Kor 14, 1.*

Bashkëpërgjegjës në Kishë

32. Kisha jonë përgjatë disa shekujve, ishte e persekutuar, e përndjekur dhe jo pak meshtarëve ju është dashur të bëjnë shumë sakrifica. Kjo sakrificë e bijve të Kishës, në të vërtetë, ka lanë një pasuri të paçmueshme fetare, kulturore, gjuhësore dhe shoqërore: në ruajtjen e dinjitetit, në formësimin e identitetit, dhe në përparimin qytetëruar të shoqërisë tonë në përgjithësi. Sidomos kur kemi parasysh meritat e vuajtjeve të besimtarëve dhe kontributit historiko-kulturor të meshtarëve.

Sipas dëshmive të ipeshkvijve të asaj kohe, besimtarët shpeshherë ishin të detyruar të jetonin deri edhe nga njëqind vjet pa meshtarë. E, jo rrallë, kësaj grigje ia rrëmbenin barinjtë e saj. Ishte një epokë kur populli ynë ishte katandisur keq, kur furtunat e stuhitë e detit dhe krisma e furia e ferrit ishin përpjekur bashkë për t'i përpirë kishat tona.³⁵

33. Edhe përvoja e komunizmit ka krijuar një dozë dyshimi dhe mosbesimi mes meshtarit, i cili, ishte i obliguar të ushtronte veprimtarinë e tij baritore

35 Khs. Kuvendi i Arbërit 1703, Prishtinë 2003, f. 384.

“*i mbyllur brenda oborrit të Kishës*”, por edhe nën vëzhgimin permanent të sistemit dhe besimtarit, i cili, ishte i detyruar që jetën shoqërore ta ndante tërësisht nga Kisha e tij. Ata që gjenin guximin të vazhdonin jetën e tyre shpirtërore me Kishën, ishin të përqendruar përgjithësisht në nevojat sakramentale, në veprat e përshpirtshme, dhe në detyrimet që ata kishin për shërbime që merrnin nga shëruesit e sakramenteve.

34. Edhe pse, dekadave të fundit, Kisha jonë ka mjaft meshtarë, rregulltarë dhe rregulltare; edhe pse shërbesa e sakramenteve është e rregullt dhe me përshpirtëri; edhe pse s'mungon dashuria e besimtarit laik për Kishën dhe besnikëria e tij ndaj Krishtit; edhe pse nuk mungon gatishmëria e meshtarëve dhe rregulltarëve/rregulltareve për t'u sakrifikuar në të mirë të besimtarëve e për shenjtërimin e shpirtave, megjithatë, një distancë, që është krijuar gjeneratë pas gjenerate, mes klerit dhe besimtarëve, është akoma e dukshme.

Sa e madhe është kjo distancë, mund të shpjegohet me dy akuza të shpeshta që ia bëjmë njëri-tjetrit, klerikë dhe laikë. Besimtari mendon se “Kisha” s'ka çka përzihet në jetën dhe përgjegjësitë e tij shoqërore, kurse kleri në përgjithësi mendon se besimtari s'ka çka përzihet në punët e fesë e të Kishës. Ashtu si Pali

apostull i përbente besimtarët e Korintit, ashtu edhe unë me fjalë të tij ju thërras përvujtërisht: “[...]pashë Emrin e Zotit tonë Jezu Krishtit: jini të gjithë një mendimi e të mos ketë përçarje ndër ju, por të jeni në përkim të plotë me ndjenja e në mendime.”³⁶

Kjo gjendje dhe marrëdhënie e ndërsjellë në popullin e Zotit, sigurisht që shkakton dhimbje të madhe tek të gjithë, veçmas te Bariu i kësaj kisha. I krishteri, s'i ka *dy jetë të ndara: një për Zotin e një për botën*, por një të vetme. Prandaj është i ftuar të jetë koherent dhe i dëgjueshëm ndaj fjalës së marrë. As klerit s'i është dhënë asgjë që të mbajë për vete, por t'i shtrojë të gjitha dhuntitë dhe hiret në tryezën e bashkësisë që iu është besuar.

35. Lypet angazhim i sinqertë dhe gatishmëri e të gjithëve, në mënyrë që kleri dhe besimtari, të ndihen bashkëpërgjegjës për jetën dhe veprën e Kishës. Nga kleri kërkohet të jetë pjesëmarrës në vuajtjet e besimtarit, sidomos familjes, gjatë përballimit të vështirësive të jetës, kurse nga besimtari kërkohet që t'i bashkohet klerit në misionin ungjillëzues, e sidomos në përgjegjësitë e mbarështimit e të mirave të përkohshme.

36 *1 Kor 1,10.*

Baritorja thirrore

36. Nga përvoja e apostujve mësojmë sesi duhet ta vëzhgojmë Shpirtin Shenjt: në lutje dhe në agjërime. Sepse ai vazhdon edhe sot të ftojë, djem e vajza, burra dhe gra, që të na bashkëngjiten në misionin tonë të ungjillëzimit. Këta të bijë të Hyjit, *me fenë tonë*, duhet t'i ndihmojmë, që nëpërmjet shoshitjes së shpirtit në uratë, t'i qetësojnë zemrat e tyre, në mënyrë që të mund ta dëgjojnë, në zemrat e njoma të tyre, pëshpëritjen e Shpirti Shenjt: “*ēja*”. Në anën tjetër, ne, me përvojën e apostujve, duhet të vazhdojmë ta dëgjojmë këtë Shpirt në uratë, në mënyrë që të dimë të përzgjedhim brenda bashkësisë ata që Zoti i ka thirrur të kryejnë veprimtarinë e caktuar në shërbim të Ungjillit.³⁷ Me dëshminë e jetës tonë, të rinjtë dhe të rejtat, duhet të gjejnë guximin t'i përgjigjën kësaj thirrje me shpresën profetike: “*ja ku jam*.”³⁸ Ndërsa me përvujtërinë e Virgjërisë Mari “ [...] *Më ndodhtë siç the ti!*”³⁹, plot bindje dhe vendosmëri të vihemi në zbatim të vullnetit të Hyjit.

37 Khs. *Vap 13, 2*.

38 *1 Sam 3,16*.

39 *Lk 1, 28b*.

37. Të rinjtë që janë të prirë për meshtari, famullitari, si Atë shpirtëror i krejt bashkësisë, duhet t'i afrojnë më afër vetes! T'i bëj pjesëmarrës në lutjen e vetë të përditshme dhe t'i ketë pranë vetës në shërbesat e tija, si ata që janë në dëgjim të thirrjes, po ashtu edhe ata që mendojnë seriozisht t'i përgjigjen kësaj thirrjeje. Për një të ri, i cili ëndërron të jetë meshtar, është shumë e rëndësishme të jetë afër *Atit të tij shpirtëror*, kur ai të kremtojë meshën me bashkësinë e së dielës.

Kërkohej, pra, që famullitari të jetë ai që i ndihmon dhe i përgatitë *të thirrurit*, në mënyrë që kur t'iu bashkëngjiten seminaristëve në Shkodër, të kenë përparuar mirë në fe; në formimin njerëzor dhe në zbulimin e thirrjes. Po ashtu, edhe përgjegjësi për thirrje, duhet t'iu vijë në ndihmë famullitarëve, duke i bashkuar në takime e lutje, në momente shqyrtimi dhe miqësie, të gjithë ata që janë duke shqyrtuar thirrjen nëpër famullitë tona.

Edhe besimtarët laikë janë të thirrur

38. Përveç atyre që do të na bashkohen në meshtari, duhet të qëndrojmë në dëgjim të Shpirtit të Zotit, i cili, na dhuron burra dhe gra laikë, për të na ndihmuar në

katekezë, në punën e bamirësisë, në administrimin e të mirave të përkohshme, po edhe në përgjegjësitë tjera që burojnë nga Ungjilli ose nevoja e kohës.

Besimtarët laikë, të cilit, me besnikëri jetojnë dhe dëshmojnë fenë, s'duhet të ndihen të braktisur nga Ati i tyre shpirtëror - famullitari - as në angazhimet e tyre në Kishë e as në përpjekjet e tyre në jetën shoqërore.

As meshtari, Ati shpirtëror i bashkësisë, s'duhet të ndihet i braktisur nga "*t'bijtë dhe t'bijat e veta*", në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave e tija të përditshme dhe nevojave që i ka.

Ndaj, pres që, besimtarët laikë të përzgjedhur nga famullitarët, sa më parë të formohen në Shkollën Katekistike që kemi filluar në Prishtinë, që pasi të jenë pasuruar me njohuritë e nevojshme, të na bashkangjiten në katekezë dhe në përgjegjësitë tjera, ku mund të kërkohet kontributi i tyre.

39. Tek ne, përgjegjësia e laikëve në kishë është shprehur përgjithësisht nëpërmjet *Këshillit të Kishës*, që deri me tani ka qenë mënyra e vetme e, nëpërmes së cilës, besimtari ka marrë përgjegjësi në Kishë. Këshilltarët kanë ndihmuar famullitarin në marrjen e disa vendimeve dhe në drejtimin e bashkësisë famullitare. Këta, Këshilltarë të Kishës, diku janë autoritet i besimtarëve

para famullitarit, diku janë mbështetës të autoritetit të meshtarit para bashkësisë, e vende vende i luajnë të dyja këto role.

40. Pasi kam takuar, pothuajse të gjithë këshilltarët nëpër Famullitë tona, gjatë vizitës sime baritore, dhe pasi i kam dëgjuar më vëmendje ata, vij në përfundim, se, përgjithësisht, kontributi i tyre është i dobishëm. Prandaj, edhe përkushtimi i tyre në shërbim të bashkësisë duhet të vlerësohet. Është mirë që Këshilli i Kishës të luajë rolin që ka; rol ky që konsiston në kujdesin për të mirat e përkohshme; për mbarëvajtjen e jetës së bashkësisë; për sigurimin e shërbesës brenda Kishë, si dhe për prezantimin e Famullisë në gjirin e shoqërisë.

41. Megjithatë, ndjehet nevoja e domosdoshme që bashkësia famullitare të ketë edhe Këshillin Baritor, i cili, do ta ndihmojë famullitarin më konkretisht në veprimtarinë e tij baritore, siç janë: përgatitja në kremtimet liturgjike, planifikimi dhe zbatimi i mësimin të fesë dhe shërbesat e tjera në dobi të shpirttrave. Përgjithësisht, sugjerohet që ky këshillë të përbëhet prej udhëheqësve të grupeve të veçanta në kuadër të bashkësisë famullitare, siç janë: bashkësitë rregulltare,

grupeve rinore, grupeve të lutjes, lëvizjet e ndryshme, kori i kishës, etj. Një këshilli baritor i koordinuar mirë, me përbërje prej *bërthamave që veprojnë si tërësi*, do të jetë dhuratë e madhe për bashkësinë famullitare dhe një lehtësim i madhe për famullitarin.

IV. FAMILJA - BASHKËSI FEJE

*Për t'i kthyer zemrat e etërve kah fëmijët*⁴⁰

42. Ishte në vullnetin e Krijuesit që njeriu të mos jetonte vetëm,⁴¹ por në bashkësi, burrë e grua. Në tërë Biblën, familja është vendi më i mirë ku takohet dhe madhërohet Hyji. Në familjen e Abrahamit, Hyji e realizoi vullnetin e Tij për të krijuar një popull për vete. “Unë e zgjodha Abrahamin që t'i mësojë bijtë e vet pas tij si dhe shtëpinë e vet ta ndjekin udhën e Zotit [...]”⁴² Ashtu sikurse e zgjodhi Familjen e Abrahamit për t'i mësuar fëmijët e tij që të bëjnë gjithçka është e mirë, e drejtë dhe drejtësi, Hyji, po ashtu, e zgjodhi Familjen e Nazaretit, për të mishëruar *Fjalën e Tij*, dhe për t'ia dhuruar botës Shpëtimtarin e vet.⁴³ Krishti, *Fjala e Mishëruar*⁴⁴, sikur e ka shenjtëruar familjen e Marisë dhe Jozefit, e shenjtëron dhe e mëson çdo

40 Lk 1, 17a.

41 Khs. Zan 2, 18.

42 Zan 18, 19.

43 Khs. Mt 1,18.

44 Khs. Gjn 1,14.

familje tjetër që të jetë e bashkuar në dashuri dhe në paqe. I frymëzon që të shndërrohen në burim gëzimi për njëri-tjetrin. Jezusi “*e naltoj mâ tepër më një dinjitet të lartë hynuer tuj e ba Sakramend, shëmbëlltyrën e bashkimit të Jezu Krishtit e të Kishës.*”⁴⁵ Të mirat bazike të një familje, janë fëmijët, besnikëria bashkëshortore dhe hiri e bekimi sakramental.

43. Një familje, e frymëzuar nga feja Abrahamike, ndjek udhën e Zotit, kurse me frymëzimin e Marisë dhe Jozefit, plot dashuri, vihet në shërbim të fëmijëve të vet, për t’i ndihmuar ata që sa ma mirë të kapin të ardhmen e tyre dhe pa frikë iu lënë në dorë trashëgiminë familjare, shoqërore dhe shpirtërore. Duke jetuar shenjtërisht jetën sakramentale me fëmijët e tyre, brenda Kishës, prindërit ushqejnë shpirtin e fëmijëve të vetë me begati e hire, ndihmojnë ata t’i përballojnë vështirësitë dhe padrejtësitë e përkohshme, dhe i përgatitin që të marrin shpërblimin e përjetësisë. Kështu, familja e krishterë, shndërrohet në *Kishëz shpije*, ku feja bëhet *jetë e të bijve t’Zotit*, e jeta shndërrohet në dhuratë dashurie për njëri-tjetrin. Këto familje, kur gërshetohen në një *rrjet feje*,

45 Lajmëtari i Zemrës Krishtit, Fruer 1930, f. 21.

dashurie, kulti hyjnor, urate etj., përbëjnë bashkësinë e krishterë të një vendbanimi ose Kishën famullitare.

44. Ashtu siç është shtëpia vendbanim fizik i atyre që jetojnë bashkë, po ashtu familja është strehë e përbashkët e shpirtit të atyre që e bashkëndajnë gëzimin e jetës, dhimbjen e vdekjes, djersën e punës dhe shpresën e jetës së pasosur.

45. Përveç kontekstit shpirtëror dhe fetar, familja shqiptare, bartë brenda vetës, një pasuri të madhe të traditës pozitive - trashëgimisë së vlerave njerëzore e shoqërore, siç janë: dëshira e flakët për pasardhës, kujdesi ndaj prindërve, besnikëria ndaj atdheut, bujaria ndaj mikut... Familjet tona, tradicionalisht kanë pasur një kullë, në qendrën e të së cilës ka qenë *votra*, rreth së cilës familjarët janë bashkuar me njëri-tjetrin, kanë bashkëndarë bukën, miqësinë dhe dhembjen. Rreth saj, i janë lutur Zotit dhe kanë inkurajuar njëri-tjetrin për fe e atdhe, për besë e burri, për qëndresë dhe shpresë.

Bri *votrës*, gjithnjë ka qenë *shtrati i pleqve*, ku është shprehur dashuria e përkryer ndaj prindërve ose gjyshërve, sidomos në momentin e fundit të jetës, kur kanë përjetuar gëzimin e kurorës së pasardhësve, që

i rrethonin. A ka gjë ma të bukur për një njeri, i cili jeton tërë jetën me ndershmëri, me mund e sakrificë, dhe në fund, plotë shpresë për të ardhmen e familjes ia dorëzojnë të mirat e tokës pasardhësve të vetë, kurse me dashuri dhe fe ia dorëzon shpirtin Krijuesit të vet.

46. Në këto *kulla* s'ka munguar kurrë impenjimi i nënave për të përkundur djepin, në të cilin, kanë rritë fëmijët - shpresën e të ardhmes së familjes, kombit dhe kishës. Karakteristikë e veçantë e kullave tona, ka qenë *nderi, besa dhe sofrë e shtrueme për mikun*⁴⁶, ku ka pasur në çdo kohë *bukë, kripë e zemër*.⁴⁷

47. Në kohën tonë, familja si edhe krejt shoqëria, po përjeton një dhimbje të madhe të kapërcimit, nga një familje tradicionale në një bashkësi bërthamë, që do të bëhet familje e së ardhmes. Ky kapërcim i shpejtë dhe i menjëhershëm, i ka trazuar zemrat e shumëve brenda "*gjirit familjar*", sepse po lëkunden themelet e "*shpi kullës*" dhe po shkohet drejt *familjes mobile*, që jeton ku do.

48. Shumë familje tona janë shpërndarë nëpër vende të ndryshme të botës me qëllim që të gjejnë *jetë më*

46 Shprehje popullore

47 Shprehje popullore

t'lehtë, mundësi ma të mëdha dhe ardhmëri më të mirë për pasardhësit e tyre. Mund të themi se gjysma e familjeve tona janë shndërruar në familje emigrante! Emigrimi vazhdon edhe sot. E ky emigrim aktual hetohet sidomos tek martesat e reja, të cilat përgjithësisht bëhen mes vajzave dhe djemve të familjeve në migrim me djemtë dhe vajzat e familjeve në Kosovë. Mjerisht, gjitha këto familje të reja vendosin të jetojnë jashtë vendit, kështu që familjet tona në vend përgjysmohen dita ditës. Me dhimbje konstatojmë se: në shumicën e rasteve, nuk është dashuria ajo që iu prinë këtyre martesave, por, në një anë, dëshira e tepruar e prindërve në migracion për të ruajtur familjen tradicionale, e në anën tjetër, lakmia e tepruar e vajzave dhe djemve në vend për të pasur mundësi ma të mëdha dhe jetë ma të lehtë jashtë vendit.

49. Familjet që jetojnë në Kosovë përballën me një gjendje të pa lakmueshme. Atyre, ju duhet të përballojnë të gjitha përgjegjësit që kanë për prindërit, për fëmijët dhe për ekonominë familjare.

Me mundësitë e pakta që disponojnë, duhet të kujdesen për formimin dhe edukimin njerëzor, fetar dhe intelektual të fëmijëve tyre, në një ambient të egër që është krijuar pas luftës. Kjo klimë e palakmueshme,

ku feja, vlerat morale, parimet njerëzore, fjala e dhënë, ndershmëria dhe sakrifica, s'kanë më rëndësi, e ku vendin e tyre e zënë lakmia, interesi, mundësia pa mëritë, konsumizmi, indiferentizmi, relativizmi dhe pabesia, e vështirësuan tejskajshëm jetën e secilit në familje.

50. Kjo gjendje e re, në të cilën jetojnë dhe në të cilën formohen familjet e reja, ka ndikuar që familjet ose shtëpitë tona, më shumë të jenë një *“fushëbetejë”* e interesit të anëtarëve dhe përplasje mes gjeneratave sesa *“strofull e ngrohët dashurie”* për prindërit dhe fëmijët e tyre. Sa të shpeshta janë pakënaqësitë mes vëllezërve që kanë mbetur te shpija, të cilët ankohen se *“s'po na ndihmoni ma”* dhe arsyetimit të atyre që janë në mërgim që arsyetohen se *“boll ma ju kemi ndihmua.”*

51. Sa të mëdha janë dallimet mes gjeneratave, kur prindërit mendojnë se fëmijët e tyre po rrënojnë gjithçka që ata kanë ndërtuar, kurse të rinjtë, në anën tjetër, ankohen se prindërit e tyre s'kuptojnë asgjë nga e tashmja që kanë arritur dhe e ardhmja që do vijë.

Madje, s'janë të rralla raste kur vëllezërit ndahen, jo pse janë krijuar mundësitë dhe kushtet, por pse në

shtëpinë e përbashkët s'ka ma paqe dhe rahati, rrjedhimisht as dashuri.

Madje, ndodh që çiftet e sapomartuara, ndahen, me arsyetimin se “s'mundem ma”, pa i dhanë mundësi duresës që të provojë qëndrueshmërinë e vetë, e as që duan të provojnë sakrificën, për të arritur pajtimin. Në të shumtën e rasteve, ky është dorëzim i pandërgjegjshëm dhe veprim i papërgjegjshëm i njërës palë, por që te dyja palët, sidomos fëmijët e tyre, i futë në një vuajtje të përhershme.

52. I gjithë ambienti dhe rrethanat, siç janë: ndryshimet e shpejta, importimi i të këqijave nga jashtë dhe shpërthimi i të ligave nga brenda, përditë sulmojnë njeriun e sotëm, me qëllim që t'ia rrënojnë vlerat mbi të cilat është rritur, t'ia zhvlerësojnë përpjekjet e tija për të qenë i ndershëm dhe t'ia përbuzin fenë si primitivizëm, për të cilën s'ka nevojë.

Ndërtuesit e “shoqërisë së re”, në vend që të rindërtojnë mbi vlerat, sakrificat dhe pasurit shpirtërore, ata përpiqen që rrënojnë ato, sepse e dinë se njeriu “*zemër bosh*”, i nënshtrohet më lehtë nevojave të interesit të tyre.

Të vetëdijshëm për këto rrethana, duhet të themi, se, është heroizëm i besimtarëve tanë, që me duresë

përballojnë këtë realitet e na rrinë afër, duke kërkuar ndihmën tonë që të ruajnë thesarin e brendshëm të shpirtit, pasuritë e trashëguara të familjes dhe vlerat e përgjithshme morale e shpirtërore.

53. Sidomos duhet vlerësuar shumë, kur dy të rinj, të nisur nga dashuria e sinqertë, i dhurohen njëri-tjetrit. E për këtë akt kaq madhor e duan bekimin e prindërve të tyre, dhe e kërkojnë që besë-lidhja e tyre të vuloset me sakramentin e martesës në Kishës. Prandaj, duhet familja dhe Kisha, me shumë dashuri, të vihen në shërbim të këtyre çifteve, që të mos ndihen të braktisura në përgjegjësitë e tyre dhe që të ndiejnë afërsinë tonë në çdo vështirësi të tyre.

Këta të rinj e këto çifte, duhet t'i takojmë më shpesh në seanca të veçanta katekizmi, lutje dhe diskutimi, që t'i ndihmojmë të ruajnë gëzimin e dhuratës së jetës, dashurinë vetëmohuese për njëri-tjetrin, besnikërinë bashkëshortore, dhuratën e fëmijëve, dhe njëkohësisht të promovojmë vlerën e paqes brenda gjirit familjar.

Paqja në familje, nuk arrihet nëpërmjet përpjekjes për të pasur, as nëpërmjet kushteve të mira për fëmijët, as nëpërmjet arsimit sa ma të lartë, por nëpërmjet duresës që nuk lodhët, dashurisë dhuruese të pakusht dhe sakrificës së përditshme. Mbi të gjitha, është e

nevojshme që ta kuptojnë se paqja në familje, bëhet e pashtershme nëpërmjet faljes dhe pajtimit, mu ashtu siç të gjithë pajtohemi me Hyjin nëpërmjet sakramentit të rrëfimit.

54. Është e rëndësishme që famullitari, ati shpirtëror i familjes, të jetë kreativ në mbarështimin e hireve dhe virtyteve, që Shpirti i Zotit ia dhuron bashkësisë famullitare nëpërmjet familjeve të famullisë. Nuk është mirë kur famullitari luan rolin e *policit moral*, duke i trishtuar zemrat, e prindërve dhe të fëmijëve mbi të këqijat. Siç janë, pabesia bashkëshortore, shkurorëzimi, abortimi i fëmijëve, droga, prostitucioni, bashkëjetesa paramartësore etj. Pasojat dhe hidhësinë e këtyre mëkateve dhe të së keqes në përgjithësi, i kanë shijuar vetë ose e kanë përjetuar për së afërmi atë, në vaujtjet e familjarëve apo miqve të tyre. Ati shpirtëror i familjes, famullitari, me dashurinë e Krishtit dhe me shpresën e fesë, të kujdeset që t'i ngushëllojë familjet dhe t'i mësojë, prindërit e fëmijët e një familje, sesi të ruhet ose si të shërohen nga këto të liga, të cilat po i rrënojnë familjet sot.

55. Familja në famullitarin duhet të sheh mësuesin e mirë “në t’përgjamt e Krishtit”, i cili, e forcon

miqësinë e tyre me Krishtin dhe i ndihmon ata të ushtrojnë fenë në gjirin e Kishës. Kur mëkatojnë, le t'i ngushëllojë zemrat e tyre me mëshirën e Zotit; le t'i nxisë që të kthehen e të besojnë; le t'i mësojë me fjalën e Shkrimit të Shenjtë, le t'i entuziazmojë për bukurinë e jetës, për vlerat e pasurisë shpirtërore, për rëndësinë e besnikërisë martesore dhe le t'i ftojë ata që të jetojnë zemërpastër e të papërlyer, me shembullin e jetës personale. Edhe kur është i nevojshëm qortimi, duhet të bëhet me dashuri dhe respekt, pa e prek integritetin, dinjitetin dhe sedrën e tyre.

56. Kur shohim se sa nevojë kanë familjet për përkrahje në përgjegjësitë e tyre, sigurisht bindemi se duhet të ndryshojmë mendësinë e vjetër, duke menduar se katekizmi ose baritorja e kishës është vetëm për fëmijët dhe të rinjtë. Përkundrazi, nevoja kërkon që të hapemi sa ma parë ndaj një baritore për të rritur. *“S’mund të lejojmë të bëjmë gabim se do të mund të ndërtojmë, në Kishë e në shoqëri, një kulturë të re në favor të martesës dhe të familjes, nëse nuk do të kemi guximin t’i ndërtojmë e t’i bëjmë stabile e vërtet vepruese organizmat dhe strukturat adekuate të pastoralit familjar.”*⁴⁸ Puna

48 Direttorio Pastorale Familiare, CEI 1993 , f. 119.

e jonë në këtë drejtim do të mundëson, në mënyrë të veçantë, familjet e reja, që ta ndiejnë afërsinë e kishës, ashtu sikurse edhe kisha do të ndiejë mbështetjen e tyre.

V. KISHA FAMULLITARE - VOTËR SHPIRTËRORE E BESIMTARIT

*Me një shpirt e me një zemër të vetme*⁴⁹

57. Familjet, kishat te shpia, e një territori të caktuar formojnë kishën famullitare. Te dyja këto kisha, duhet të jenë bashkësie, në të cilat jetohet feja. Votër shpirtërore ku shkëmbehen dhuratat e dhuntive dhe hireve. Ndaj, kërkohet që këto dy njësi, ma të rëndësishme të Kishës dioqezane, të mund të vet-ungjillëzohen dhe të bashkë-ungjillëzojnë.

58. Para se t'i kthehemi realiteti tonë, të *kishave Bashkësi Famullitare*, të shkojmë pak në zanafillën e themelimit të kishave vendore. Dëshmia apostolike na mëson se gjatë përhapjes së Ungjillit në vende të ndryshme, ishte e dobishme që të themeloheshin Kisha - bashkësi ku do të vazhdonin ushtrimin e fesë ata që besonin dhe pagëzoheshin. Para këtyre kishave,

49 Khs. *Vap* 4, 34.

Apostujt, dëshmonin se ishin Nxënës - dëshmitarë të Krishtit, shërbëtorë në shërbim të veprës së Shpirtit Shenjt, dhe quheshin etër të bashkësive që krijojnë. Pjetri, apostulli i Krishtit, i ftonë njerëzit që t'i afrohen Krishti “*Gurit të gjallë, [...] që edhe ju, si gurë të gjallë të ndërtoni Shtëpi shpirtërore, për të qenë meshtari e shenjtë, për të kushtuar fli shpirtërore, që i pëlqejnë Hyjit nëpër Jezu Krishtin.*”⁵⁰ Shën Pali, i quante kishat e veta gjymtyrë të njëjtë trup: “*Tashti, ju jeni trupi i Krishtit dhe, secili prej jush, gjymtyrë e tij.*”⁵¹ Të pagëzuarit, si “gjymtyrë të gjalla” ishin një shpirt e një zemër⁵² dhe kishin një qëllim “*që të besojnë “... në Jezu Krishtin dhe ta duam njëri-tjetrin, si Ai na urdhëroi.*”⁵³

Kishat vendore, të bashkuara rreth apostujve, bashkëndanin gëzimin e Ringjalljes, dhuratat e Shpirtit Shenjt, lutjet e përbashkëta dhe pasuritë materiale që kishën. Apostujt, me jetën dhe veprën dëshmuese, ishin në shërbim të Shpirtit Shenjt, sepse ata flisnin “*ashtu si Shpirti Shenjt i shndriste të shpreheshin*”⁵⁴ - mësonin Kishën se: “*Vetë Shpirti Shenjt dëshmon bash-*

50 *1 Pjt 2, 4-5.*

51 *1 Kor 12, 27.*

52 *Khs. Vap 4, 32.*

53 *1 Gjn 3, 23.*

54 *Vap 2, 4b.*

*kë me shpirtin tonë se jemi fëmijët e Hyjit.*⁵⁵ Apostujt, me autoritetin e Shpirtit Shenjt, themelonin Kisha dhe u caktonin këtyre kishave drejtues, i mësonin, i këshillonin dhe i qortonin me dashuri. Nga ana tjetër, të pagëzuarit e një vendi-kishe “*ishin vazhdimisht të kujdesshëm për ta përvetësuar mësimin e apostujve dhe nuk mungonin në mbledhjet vëllazërore, në ndarjen e bukës e në lutje*”⁵⁶, kurse të mirat e veta të përkohshme, i venin në shërbim të të gjithëve.⁵⁷

59. Sipas mësimit të Koncilit II të Vatikanit, të pagëzuarit që bashkohen në një trup të vetëm të Krishtit, janë populli i Hyjit. Ata, të rilindur, si të bijtë e Hyjit, marrin huret sakramentale, dëshmojnë publikisht fenë që kanë marrë prej kishe, i bashkohen veprës misionare të Kishës, ushtrojnë dashurinë ndaj vëllazërve, dëgjesën në fe ndaj barinjve; marrin me gëzim përgjegjësitë që i kanë brenda bashkësisë, dhe hapen për të komunikuar me të tjerët.

60. Ipeshkvit, si mbarështues i kishës vendore, i besohet i tërë kujdesi për shpirtra dhe për Fjalën, mbarësh-

55 *Rom 8, 16.*

56 *Vap 2, 42.*

57 *Khs. Vap 4 34-35.*

timi i pasurive të hireve sakramentale dhe të mirave të përkohshme. Meshtarët, si bashkëmbarshtues me ipeshkvin, duke vepruar në misionin e Krishtit; në shërbim të Kishave famullitare, ushtrojnë kultin hyjnor; ua shpallin të gjithëve Fjalën e Hyjit; ua ndajnë besimtarëve hiret sakramentale dhe i bashkojnë ata në flinë e përbashkët Eukaristike. Lutet për ta, dhe me ata lutet për Ipeshkvin dhe për të gjithë Kishën. Kështu e bëjnë të pranishëm Krishtin në mesin e tyre, dhe para tyre, ia paraqesin Atij lutjet, sakrificat dhe vuajtjet e besimtarëve. Në bashkësinë famullitare, të gjithë të pagëzuarit, atë që kanë besuar ua shpallin tjerëve dhe, atë që u shpallin, e zbatojnë në jetën e tyre të përditshme. Kurse sa iu përket përgjegjësisë, ato i takojnë famullitarit, i cili, i bashkëndanë me bashkëpunëtorët që ia ofron Ipeshkvi, kurse barrën e këtyre përgjegjësisë e shpërndanë mbi ata që i përzgjedhë, në bazë të karizmave që i njeh te besimtarët e vetë.

61. Përveç përvojës apostolike, dëshmime biblike dhe mësimi koniliar, si bazë mbi të cilën duhet ndërtuar *mendimin dhe veprimin*, për të ardhmen e bashkësisë famullitare, kemi edhe përvojën e mëparshme të Kishës tonë dioqezane. Kisha jonë, sikur kemi theksuar edhe më parë, mbartë në vete një përvojë të lashtë

që nga koha apostolike - rrjedhimisht edhe bashkësitë tona famullitare, janë të konsoliduara. Kanë një përvojë dhe traditë koherente, nuk mungon prania e besimtarëve, e motrave rregulltare dhe famullitarëve. Rregullisht bëhet shërbesa liturgjike; denjësisht shërbehen sakramentet e Kishës, nuk mungon katekizmi për sakramente, vendet e kultit mirëmbahen me dinjitet, dhe të mirat e përkohshme administrohen mjaft mirë. Mirëpo, kjo s'do të thotë se një gjë e tillë mund të plotësojë nevojat e besimtarëve sot, e as kërkesat e koncilit. Aq më pak, udhëzimet e Papëve të fundit për nevojën e ungjillëzimit të ri. Sidomos, s'mund t'i plotësojnë kërkesat e katekumenve, që presin të rigjejnë Krishtin, në shpinë e tyre të dikurshme shpirtërore - Kishë e të parëve.

*Por gjithmonë bëni të përparojë
e mira ndër ju...!⁵⁸*

62. Është pra më se e qartë që çdo kishë famullitare, duhet të jetë bashkësi e të pagëzuarve, të cilët, në bashkësitë e tyre familjare, plot fe, shpresë dhe dashuri, jetojnë jetën me Zotin. Të gjithë këta ndërtojnë kishën

58 *1 Kor 5,15b.*

e tyre, si shtëpi të përbashkët shpirtërore, në të cilën bashkohen me Krishtin - në uratë, bëhen pjesëmarrës në thyerjen e bukës; ushqehen dhe i ushqejnë fëmijët e vetë, me Fjalën që jep jetë, me Bukën e jetës së pasosur, me dhuntitë e Shpirtit Shenjt, me hiret sakramentale dhe me mëshirën e Zotit.

63. Bashkësia e besimtarëve – Famullia – është jeta e kishës dioqezane, ku në realitet jetohet feja, përballohen sfidat e jetës dhe nga ku kumbon më së miri kumti ungjillor. Në realitetin e kishës sonë dioqezane, kemi rrethana të veçanta që e krijojnë një gjendje të përzier mes gjeneratave, si të prindërve besimtarë ashtu edhe të priftërinjve famullitarë. Në njërën anë, është Famullia tradicionale, e cila, ndërtohet mbi perceptimin e shumicës së bashkësisë, dhe mbështetet mbi forma tashmë të stabilizuara, ku të rriturit dhe të moshuarit nuk dëshirojnë të ndryshojnë asgjë. Ndërsa në anën tjetër, janë të rinjtë, të cilët duke iu përshtatë rrethanave të reja, dëshirojnë të kenë më shumë pjesëmarrje në bashkësi dhe më shumë dobi prej saj. E kur së gjejnë hapësirën e nevojshme, kërkojnë të ikin dhe s'duan asgjë.

Të rriturit dhe të moshuarit derisa përpiqen për të ruajtur atë që kanë ndërtuar me kujdes, duhet të

jenë vigjilentë që të mos dëmtojnë shermendet e rinj në vreshtin e Hyjit e as t'i ngufasin dëshirat e të rinjve për të dhënë kontributin e tyre, nganjëherë edhe plotë entuziazëm.

Të gjithë jemi të thirrur, që duke *u shtri për të kapë të rejën*, të mos dëmtojmë *frytet e mëparshme* të mirësisë, të punës dhe të sakrificës së të rriturve, por urtësisht dhe përvujtërisht, të angazhohemi që të përparojë e mira në bashkësitë tona, në mënyrë që, famullitë tona, të bëhen strehë e sigurt, ku besimtari do të mund të gjejë ngushëllimin, gëzimin e shpresës dhe shpëtimin për vete dhe për fëmijët e vet. Është e nevojshme që të gjithë, brenda Kishës - bashkësi famullitare, t'i përgjigjen kësaj nevoje.

Famullitari - Atë shpirtëror i të gjithëve!

64. Në radhë të parë, famullitari, si atë shpirtëror i të gjithëve, përveç shërbesës meshtarake, që buron nga thirrja dhe nga shugurimi i tij meshtarak, bëhet *prani e Krishtit*, në mesin e bashkësisë famullitare. Ai, duhet të angazhohet përditë që të rifreskojë fenë e tij personale, të bëjë të vetin çdo gëzim të besimtarëve, bujarisht t'i vë në shërbim të nevojave të tyre të gjitha dhun-

titë e tija, dhe të rri zgjuar në uratë e i gatshëm për të bashkëndarë çdo dhimbje, me personat dhe familjet që e përbëjnë grigjën e tij. Në anën tjetër, famullitari, si shërbyes i përvuajtur i *kultit hyjnor - liturgjisë* dhe mbarështues i vyer i sakramenteve, duhet të kujdeset që e tërë bashkësia të përparojë “*në shenjtëri e drejtësi para Hyjit.*”⁵⁹

65. Mbi të gjitha, duhet të kihet kujdes që famullitari - ati shpirtëror i bashkësisë – të mos sillet si pronar që i ruan të mirat e qiellit në një “*magazinë shpirtërore që e quajmë kishë*”, çelësin e të cilës e ka vetëm ai. Porse, le të punojë si shërbëtor i përvuajtur, dhe të kujdeset, që të gjithë, të bijtë e të bijat e tij në shpirt, të kenë me bollëk të mirat e shpirtit, të jenë të veshur me drejtësi dhe t’u prijë atyre në rrugën e shenjtërimit. Gjatë shtegtimit tokësor, t’i nxisë të gjithë, që me gëzim dhe dashuri, t’u afrohen të mjerëve, t’ju ndihmojnë të sëmureve dhe t’i bashkëndajnë me të varfëritë të mirat materiale. Është e nevojshme që çdo besimtar të bëhet misionar i ungjillit dhe të kujdesën bujarisht për nevojat që ka bashkësia.

59 Khs. *Lk 1,75*.

66. Të pagëzuarit që jetojnë jetën fetare në përditshmëri; te shpija, s'duhet të mendojnë kishën e tyre famullitare si një sipërmarrje të Zotit, të Papës, të i ipeshkvit ose të famullitarit të tyre, as sikur një “*supermarket*” ku mund t'i gjejnë të mirat shpirtërore, as si një “spital të shpirtrave të tyre”, as një “deponim” ku mund t'i hedhin mëkatet e veta, as si një “pistë” nga ku mund të ngritën në qiell, por si Shtëpi e tyre e përbashkët, ku të gjithë me dashuri, me përvujtëri, *japin e marrin*, sipas nevojave që kanë. Së bashku bartin barrën e jetës, dhe që të gjithë fitojnë faljen e mëkateve dhe marrin dhuratën e shëlbimit.

Famullia - shtëpi e përbashkët ku të gjithë kanë përgjegjësi

67. Si famullitari, ashtu edhe Këshilli i Kishës, duhet të kujdesen që Kisha famullitare të jetë e hapur gjatë gjithë ditës, e jo vetëm në kohën e shërbesave liturgjike dhe lutjes së përbashkët. Por, në çdo kohë, njerëzit, besimtarë e jo besimtarë, duhet ta gjejnë kishën e hapur, për ta strehuar shpirtin e tyre në praninë e Zotit. Në anën tjetër, është e drejt që i kemi rregulluar mirë shtëpitë e famullive, por kjo bukuri humbë

shkëlqimin, nëse brenda saj nuk gjendet famullitari, i cili, çdo ditë duhet t'i presë, me dashuri dhe bujari, besimtarët e besimtare, e pa përtesë të vihet në shërbim të nevojave të tyre. Shtëpia e famullisë, kohët e mëparshme, është quajtur “Qelë”, që ka nënkuptuar “shtëpi e hapur”. Brenda bashkësisë famullitare “qela” duhet të jetë votër e ngrohtë, shtëpi mikpritëse, prag i besës dhe i shpresë për besimtarin.

Famullitari, duke mirëpritur me dashuri besimtarët, duke i dëgjuar me kujdes hallet e tyre dhe duke i këshilluar e ngushëlluar me fjalën e Zotit në çdo kohë; nga barë shpirtëror i të gjithëve në bashkësi, bëhet edhe *Atë shpirtëror* për personin dhe familjen e tij. Ndërsa shtëpinë e famullisë e shndërron, nga një shtëpi – zyrë, në *shtëpinë e shtëpive të famullisë*.

68. Çdo besimtar, duhet të jetë i gatshëm për të dhënë kontributin e vetë, në mënyrë që të ndihmojë mbarëvajtjen dhe përparimin e bashkësisë famullitare. Sidomos, kur u kërkohet të marrin pjesë në këshillin Kishës ose në Këshillin baritor. Famullitari dhe bashkësia, kur kërkojnë përgjegjësi të veçanta nga një anëtar i bashkësisë famullitare, duhet të kenë parasysh që i përzgjedhuri të jetë person me integritet, i nder-

shëm dhe “n’za t’mirë.”⁶⁰ Është mirë, por edhe shumë e dobishme që anëtarët e Këshilli të Kishës t’ia paraqesin famullitarit gjendjen reale të vështirësive që kanë njerëzit, dhe para besimtarëve të shpalosin nevojat që ka bashkësia. Ata, së bashku, duhet ta artikulojnë qartë mendimin e besimtarëve para famullitarit dhe me të njëjtën qartësi të përçojnë vullnetin e famullitarit te ta. Në këtë mënyrë, edhe në famullinë më të madhe, famullitari do të ndiejë prekjën e zemrave falënderuese të besimtarëve të vetë, po edhe çdo besimtar, do të mund të ndiejë kujdesin atëror të famullitarit, nëpërmjet bashkëpunëtorëve të vet baritor. Mbi të gjitha, duhet që çdo këshillë kisha, t’ia ofrojë famullitarit dy vetë, të cilët, do të ndihmojnë famullitarin në përkujdesjen e tij për të mbarështua të mirat e përkohshme.

69. Është më se e nevojshme që brenda bashkësisë famullitare, të mbështeten besimtarët që janë të organizuar në shoqata, lëvizje apo grupe, që jetojnë dhe dëshmojnë në mënyrë ma aktive fenë.

Po ashtu është e dobishme që famullitari t’i nxitë besimtarët e tij që, përveç pjesëmarrjes në shërbesa liturgjike, kremtime të sakramenteve, shtegtime ose

60 Shprehje popullore për njeriun e ndershëm që gëzon respekt.

lutje të përbashkëta në kishë; të nxisë besimtarët të organizohen në njësi, më të *mëdha se familja* e ma të vogla se *bashkësia famullitare*, siç janë kori i famullisë, kori i fëmijëve, grupi i të rinjve, grupi i veprave bamirëse ose *caritasi i famullisë*, grupi i intelektualëve.

Në këtë mënyrë, besimtarët do të mund të përkryejnë karizmat e tyre të veçanta, kurse famullitari do të arrin t'i kryejë më lehtë përgjegjësitë që ka. Me frytet e këtyre karizmave, sigurisht do të forcohet më shumë bashkësia famullitare, dhe do të pasurohet kisha dioqezane, kurse shpallja e ungjillit, do të dëshmohet me vepra konkrete të atyre që kanë besuar.

70. Ne s'kemi shumë bashkësi rregulltare që kanë selitë e tyre, mirëpo, kemi rregulltaret, të cilat veprojnë nëpër famullitë tona. Ato natyrshëm janë pjesë përbërëse e jetës baritore të një bashkësie famullitare. Ato, kryejnë detyra, nga më të ndryshme dhe të përditshme, si ato që shihen ashtu edhe ato që nuk shihen nga gjithë. Ato, shërbejnë me dashuri dhe kujdes, në parapërgatitjen e çdo shërbese liturgjike, iu prijnë aktiviteteve të veçanta baritore dhe angazhohen për mirëmbajtjen e sendeve të shenjta. Këndej duhet të kihet kujdes që, edhe ato, të gëzojnë respekt të veçantë,

si nga ana e besimtarëve, po ashtu edhe nga ana e famullitarëve.

Po ashtu, kërkohet që të kenë hapësirën e bollshme për ta ushtruar karizmin e tyre, dhe për ta mbjellë atë brenda bashkësisë famullitare. Edhe ato, janë të ftuara që të mos shmangen nga jeta në famulli dhe me famullinë, në emër të karizmës, por të kujdesen që pikërisht karizma e tyre t'i bashkojë ato me bashkësinë famullitare. Nuk është e pëlqyeshme kur motrat rregulltare, e shohin karizmën si një të drejtë që duhet t'ju takon atyre për ta ushtrua, por duhet që ato t'ia ofrojnë karizmën e tyre bashkësisë famullitare si dhuratë të veçantë të përsëritjes që ia dhurojnë bashkësisë. Motrat e nderit, duke shërbyer me përvujtëri, dashuri dhe kujdes, kuptohet me karizëm në zemër dhe, pasi të kenë krye detyrimin ndaj bashkësisë, nuk duhet të hezitojnë që të vihen në shërbim të shërbyesve të Ungjillit, në famulli. Ato, duhet të jenë pjesa ma e gjallë e bashkësisë famullitare; të jenë gëzimi dhe entuziazmi i të rinjve, në “mësim feje”, në korin e kishës dhe në animimin e aktiviteteve të tjera brenda bashkësisë famullitare.

71. Famullitari, si përgjegjës dhe drejtues i bashkësisë, ka për detyrë që t'i bashkojë në një këshillë baritor ata rregulltarë dhe laikë që, në mënyrë aktive ose vullnetare, janë të impenjuar në jetën e bashkësisë famullitare. Në

mënyrë që, t'i angazhojë të gjithë bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtoret, në shërbesën baritore të bashkësisë, por edhe të jetë i ndihmuar prej tyre, në përgjegjësitë që ka. Të bashkuar në një këshillë baritor, shërbesa e secilit do të jetë më e frytshme, më gjithëpërfshirëse dhe më e dobishme për gjithë bashkësinë.

Asnjëherë s'duhet t'i lejojmë vetës logjikën, "s'kam nevojë për ty" ose "e bëj vet". Por, të përqafojmë parimin ungjillor të vëllazërimit dhe të bashkëndarjes, si ata që kanë një shpirt të vetëm dhe një zemër të vetme.

Rrjeti bashkëpunues i famullive

72. Është më se dobishme që Famullitë të mos veprojnë si qeliza të vetmuara, por të koordinohen me famullitë e tjera për rreth, sidomos me ato të të njëjtit Dekanat. Dekanët, së bashku me famullitarët, kanë për detyrë të ushqejnë këtë shpirt bashkëpunimi dhe përafrimi mes bashkësive famullitare dhe besimtarëve me Kishën Di-
oqezane. E tërë bashkësia dhe çdo gjymtyrë e saj: të pagëzuar, të kushtuar dhe të shuguruar, kler e laikë, duhet të vazhdojnë të angazhohen që të bëjnë realitet lutjen, e meshës së përditshme, për të qenë të lirë nga të gjitha të këqijat dhe që të mos na mungojë kurrë paqja dhe pajtimi.

VI. KATEKEZA - SHKOLLË E FESË

Të ftuar për të kumtuar Ungjillin e Krishtit

73. Si dokumentet e Koncilit II të Vatikanit, ashtu edhe magjisteri i kishës, na mëson se veprimtarët kryesorë në veprën baritore të Kishës janë ipeshkvi, presbiteri, diakoni, rregulltarët, rregulltaret edhe besimtarët laik.

Edhe pse ungjillëzimi është detyrë primare e ipeshkvit, askush s'mund t'i shmanget kësaj përgjegjësie, sepse të gjithë nëpërmjet pagëzimit jemi pjesë e njëjtit hire, dhe rrjedhimisht, në secilin bie përgjegjësia e kumtit dhe dëshmisë. Ipeshkvi, duke kryer detyrën e tyre të mësimi "duhet t'ua kumtojnë njerëzve Ungjillin e Krishtit."⁶¹ Prandaj, edhe kujdesin me përkushtim, që të ketë mësim të rregullt dhe formim permanent në fe për gjithë besimtarët e vetë. Ipeshkvi, këtë përgjegjësi e kryen përgjithësisht në-

61 Koncili II i Vatikanit, *Dekreti mbi misionin baritor të ipeshkvijve në Kishë "Cristus Dominus"*, n. 12, Shkodër 2012. (në vazhdim CD).

përmjet meshtarëve që iu beson njësitë e veçanta të kishës, sidomos famullitë.

74. “Famullitarët, [...] gjithashtu, me një përgatitje katekistike të përshtatshme për moshën e secilit, duhet t’i drejtojnë besimtarët në njohjen e plotë të misterit të shpëtimit.”⁶². Mu për këtë, “u takon meshtarëve, në cilësinë e tyre si edukatorë të fesë, të kujdesen, vetë apo nëpërmjet të tjerëve, që secili nga besimtarët të udhëhiqet në Shpirtin Shenjt për të zhvilluar thirrjen personale sipas Ungjillit; për të praktikuar një dashuri të sinqertë dhe aktive; për të ushtruar atë liri me të cilën Krishti na ka liruar.”⁶³

Edhe pse famullia është bashkësi e cila lutet, jetëson fenë, kultivon frytet e shëlbimit, jeton e bashkuar rreth Krishtit, duke u ushqyer me virtyte, me hire, me mëshirë, me bukën e jetës dhe me fjalën e amshueshme, ajo, në të njëjtën kohë, është “shkollë feje”, ku duhet të zhvillohet mësimi i katekumenve dhe formimi atyre që janë pagëzuar, që ta njohin Zotin që i *do dhe e duan*, që të mësojnë atë që besojnë

62 CD, n. 30.

63 Koncili II i Vatikanit, *Dekretet mbi mbarëshkrimin dhe jetën e priftërinjve “Presbiterium ordinis”*, n. 6.; khs. edhe n. 4., Shkodër 2012. (në vazhdim PO).

dhe të dinë të shpallin atë që kanë besuar. Katekeza, si *baritore e mësimit të fesë*, është e domosdoshme në çdo famulli dhe për të gjitha gjeneratat, pa përjashtuar askënd.

Udhëzimet kryesore për mësimin të fesë

75. Janë 5 shtylla kryesore mbi të cilat duhet ndërtuar programi vjetor i *mësimit të fesë - katekizmit*:

- **Edukimi permanent i fëmijëve**; thellimi gradual i tyre në misteret e fesë, përballja e tyre, hap pas hapi, me të vërtetat e fesë, dhe njohja e tyre me pasurinë e hireve, që do të marrin, nëpërmjet sakramenteve të Kishës, sidomos rrëfimit, kungimit dhe krezmimit.
- **Baritorja për të rinj**; duhet të jetë vazhdimësi e bashkëndarjes së të mirave shpirtërore brenda Kishës. Katekeza për të rinjtë, duhet të jetë më shumë një miqësim i të rinjve me Krishtin dhe një kujdes amënor i Kishës, për nevojat e të rinjve të vet. Ata duhet të ndiejnë, se, Kisha Nënë, e cila, i ka edukuar në fe, vazhdon t'i përcjellë ata në përballje me përgjegjësitë e para të jetës së tyre. Të rinjtë, sot, kanë nevojë për mbështetje dhe përkrahje. Sido-

mos kur duhet të përballen me dashurinë e tyre për prindërit dhe mospajtimin me ta, për shumë gjëra të së sotmes dhe të së ardhmes; kur duhet të përballen mes dëshirës së natyrshme për t'u martuar e për të pasur familje, dhe përgjegjësive që duhet t'i kenë si bashkëshortë e si prind. Veçmas ata presin ndihmën tonë, për t'u përballë me realitetin, që i mbushë me dyshime, pasiguri e frikë. Ata, gjithnjë shtrojnë pyetjen: Si t'i marrim përgjegjësitë, me mundësitë e pakta që kanë dhe me gjërat e shumta që ju mungojnë.

- **Baritorja me të rinj**, më shumë se një mësim, duhet të jetë, *përcjellje hap pas hapi*, që të rinjtë tanë të mund të familjarizohen me Shkrimin Shenjt, të miqësohen me Krishtin e Ringjallur, të ecin gjurmëve të Tija, në mënyrë që të mësojnë se përgjegjësitë që kanë - për vete dhe për të ardhmen - nuk arrihen me mundësitë që i kanë, por me flijimin që duhet ta bëjnë. Mos të pushojmë asnjëherë, që të rinjtë, në mënyrë të prekshme ta përjetojnë Kishën si bashkëudhëtare, deri sa ecin drejt *moshës së të rriturve*.
- **Përgatitja e katekumeneve**; për ta njohur fenë dhe për të mësuar magjisterin e Kishës- mësimin biblik

- katekizmin dhe traditën e saj. Deri në atë masë sa që të kenë formim të mjaftueshëm shpirtëror dhe të kenë edukimin e nevojshëm kishtar.⁶⁴ Përveç se duhet t'i mësojmë për të vërtetat e fesë, ata kanë nevojë për shoqërim; për t'u inkuadruar në bashkësinë e krishterë dhe presin që të jenë të pranuar me dashuri. Këndeje, është më se e nevojshme, që katekumenët të kenë që në fillim të ecjes së tyre, nunin ose nuneshën, i cili do t'i shoqërojë deri në pagëzim, po dhe do të kujdesët për ta pas pagëzimit.

- **Baritorja me familje**, kur të rinjtë tanë të arrijnë moshën e të rriturve, ata duhet të ndiejnë pranë kishën e cila vazhdon t'i përcjellë në jetën e tyre. Është më se e domosdoshme që të kërkohen mënyra ma të mira, për përgatitjen e të fejuarve për sakramentin e martesës dhe për detyrat që bartë në vete jeta bashkëshortore. Por, gjithnjë, duke vlerësuar me dashuri dhe përgjegjësi, rrethanat në të cilat gjenden të fejuarit sot. Nuk duhet të nënkuptohet përgatitja për kurorë si një katekezë rasti, por si një fillim i baritores me familje, brenda bashkë-

64 Khs. Koncili II i Vatikanit, *Dekreti mbi formimin meshtarak "Optatam totius"*, n. 8, Shkodër 2012. (në vazhdim OT).

sisë famullitare. Këndeje është e nevojshme që në famullitë tona, sidomos në ato që janë më të mëdha, të organizohet baritorja familjare, në mënyrë që, sidomos familjet e reja, të përjetojnë Kishën pranë në përgjegjësitë që kanë për edukimin e fëmijëve, jetën në fe dhe qëndrueshmërinë në besnikëri. Famullitari po edhe gjithë të tjerët që kanë përgjegjësi për baritoren me familje duhet të kenë kujdes që të mos i ftojnë familjet që t'i mësojnë mbi fenë, por t'i shoqërojnë ato udhës së fesë.

- **Baritorja për grupet e veçanta – Diakonia** – Bashkësia famullitare në vete, ka edhe grupe të veçanta, prandaj është më se domosdoshme të shtojmë kujdesin për ata që janë në nevojë: personat me aftësi të kufizuar, jetimët, të sëmurit, të varfërit dhe pleqtë e vetmuar. Të gjithë këta, kanë nevojë ta kenë pranë Kishën dhe ta prekin dashurinë që buron prej saj. Këndeje, le të organizohet e gjithë bashkësia, dhe në krye me famullitarin të bëhet ngushëllim, gëzim dhe shpresë për gjithë këta, duke mos i përjashtuar nga as një dhunti dhe nga as një sakrament, dhe nga ngjarjet e rëndësishme brenda bashkësisë.

76. Është pra në përgjegjësinë e famullitarit, që në bashkëpunim me ipeshkvin dhe me strukturat dio-

qezane, të kujdeset të përgatisë planin baritor - vjetor, për famullinë e vetë, duke pas parasysh gjithnjë koordinimin me famullitë tjera në dekanat dhe harmonizimin e këtij plani me iniciativat dioqezane.

Famullitari duhet të bashkëpunojë me dashuri me bashkëpunëtorët që i ka dhe të angazhohet që të gjejë bashkëpunorë të ri, të cilët, pasi t'i ketë përgatitur mirë, i inkuadron në punën vetë baritore, brenda bashkësisë famullitare. Është e nevojshme që të orientohemi sa më shumë në një baritore gjithëpërfshirës, e cila përfshinë tërë bashkësinë famullitare, si për t'u katekizuar ashtu edhe për të katekizuar.

Që të realizojmë një veprimtari të frytshme baritore, duhet të kemi guximin për të ndryshuar të deritanishmen dhe urtinë kreative për t'iu përshtatë kërkesave të kohës. Por, meshtarët dhe rregulltarët, sidomos ata të moshave të reja, duhet të dinë se nuk mund të ketë sukses e fryt asnjë iniciativë e re baritore, nëse menjëherë braktisim të mëparshmen dhe mundohemi të imponojmë të renë. Ata duhet, me urti dhe me duresë, të bëjnë hapat gradual dhe të sigurt, në mënyrë që asgjë të mos braktiset me përbuzje, por t'i shtohen, kujdesit tonë baritor, nevojat e tjera të bashkësisë, duke përdorë mundësit e reja që na ofrohen.

77. Mungesa e katekizmave, për moshat dhe grupet e veçanta, e vështirëson punën tonë baritore, pasi nuk mund t'iu japim në dorë, fëmijëve, të rinjve, një mjet të nevojshëm për përparimin e tyre në fe. Mirëpo, s'mund të themi se na mungojnë mundësitë e reja që i kemi, për të punuar më me shumë përkushtim. Nuk mungojnë mjetet për shumëzim, nuk mungon literatura për përgatitje, e në shumicën e famullive tona, nuk mungojnë as hapësirat e nevojshme. Prandaj, është e domosdoshme që të mos kursehemi dhe të mos kursejmë asgjë për të përmirësuar cilësinë baritore brenda bashkësisë famullirare.

Që famullitari të mund të arrijë t'iu përgjigjet të gjitha këtyre nevojave, ai duhet të jetë shtytësi kryesor i gjitha iniciativave, dhe njëkohësisht, siç kemi thënë më lartë, duhet të përzgjedhë brenda bashkësisë famullitare të rinj, burra dhe gra, që t'i dërgoj në shkollën katekistike, të cilët, pastaj në mënyrë vullnetare, do t'i bashkohen në kryerjen e përgjegjësive të veçanta.

78. Të gjitha grupet baritore në famulli dhe të gjithë katekistët, duhet të përqendrohen në thelbin e katekezës që është Bibla, në fenë e Kishës dhe në shërbesën liturgjike, sidomos në celebrimin e sakramenteve dhe në meshën e së dielës. Kremtimet liturgjike, duke u

shërbyer me shenja dhe fjalë, bëjnë realitet mësimin e katekezës, në jetën reale të besimtarit, i cili, me fuqinë e fesë ndërlihdhë mirë brenda jetës së tij përgjegjësitë njerëzore me atë fetare.

79. Jam më se i vetëdijshëm, se, mungojnë edhe doracakët baritore, për grupmoshat e veçanta dhe për kërkesat tjera që burojnë nga ky planë baritor; na nevojitet më shumë mund, për të qenë frytdhënës, lypet që t'iu përshtatemi rrethanave që i kemi dhe t'i përdorim ato pak mundësi sa ma mirë. Kemi disa libra dhe katekizma, nga fondi i mëparshëm që ka botuar DRITA, Konferenca Ipeshkëvore e Shqipërisë, por edhe njësitë e veçanta të Kishës në Shqipëri, kanë botuar libra të shumtë të cilët janë më se të dobishëm.

Është në përgjegjësinë e Këshillit Katekistik, që të përgatisë sa ma parë që të jetë e mundur, katekizmat e nevojshëm.

VII. VEPRA MISIONARE NË REALITETIN TONË

Vëllezër me të gjithë

80. Ipeshkvi si bari, strukturat dioqezane dhe njësitë kishtarë, sidomos famullitë, janë të ftuar që t'ua shpallin Ungjillin të gjithë atyre që akoma se kanë përqaftuar Krishtin, të dialogojnë me respekt dhe guxim; me të gjithë ata që nuk e ndajnë të njëjtën fe, me ata që besojnë, por s'na bashkohen në Kishë, por edhe me ata që s'besojnë fare. Në mënyrë që deri sa shpallim dhe dëshmojmë Krishtin të jemi: *“Kishë që di të bashkëjetojë dhe të ndajë fatin njerëzor me çdo njeri, me çdo besim, me çdo racë e me çdo komb, duke udhëhequr në aspiratat e ndërtimit të një bote në paqe e drejtësi.”*⁶⁵

81. Nëpërmjet kësaj forme dialogu dhe bashkëpunimi me të tjerët, ne jemi kasnecë, kumtues të Ungjillit; derisa ju shpallim atyre pasurinë e ungjillit, ne mëso-

65 Imzot Dodë Gjergji, *Predikimi me rastin e intronizimit*, Prizren, 29 dhjetor 2007.

jmë për përvojat dhe për vlerat shpirtërore të tyre. Kur i njohim vlerat shpirtërore të tjerëve, mund t'i kuptojmë më shumë dhe të promovohet vëllazëria më lehtë. Ndaj, s'mund të mos e bashkëndajmë me të gjithë përvojën tonë të fesë, dobinë e sendeve të krijuara, përgjegjësitë qytetare, dhe të mirat e përbashkëta të vendit. Mbi të gjitha duami që të miqësohemi me të gjithë ata, me të cilët jemi bashkëpërgjegjës, për ruajtjen e paqes, për ushtrimin e lirive dhe për kultivimin e identitetit të përbashkët.

*Që të gjithë të jenë një*⁶⁶

82. Sot, pothuajse gjithë të pagëzuarit, të shpërndarë nëpër kisha të ndryshme, pajtohen se ndarjet mes të krishterëve është një *shkandull për botën*, kurse përpjekjet ekumenike, si lëvizje e përbashkët e kishave, shansi i vetëm për bashkimin e të krishterëve.

83. Ekzistojnë shumë përpjekje dhe iniciativa në nivele të ndryshme kishtare, nga të cilat, për shkak të rrethanave, jemi të përjashtuar, por, megjithatë, ekzistojnë mundësi të bollshme, ku ne mund të bëjmë

⁶⁶ *Gjn 17, 21a.*

hapa konkret ekumenik, brenda realitetit tonë. Tradicionalisht kemi Kishën Ortodokse dhe besimtarët ortodoks, që jetojnë në territore të disa famullive tona. Kënde, s'duhet të hezitojmë që të hapemi ndaj tyre, t'i pranojmë me respekt dhe dashuri, kur na ofrohen, dhe të punojmë me kujdes për një pajtim të vërtetë. Pa pajtim, s'mund të mendohet për miqësi të reja; dhe pa miqësim të ri, s'mund të paramendohet angazhimi i përbashkët për t'u afruar në fe.

84. Në anën tjetër, nëpër fshatra dhe qytete tona, gjejmë gjithnjë individë ose grupe të kishave të reformuara, apo edhe struktura të organizuara, siç është: Këshilli i Kishave Ungjillore në Kosovë. Është mirë të intensifikojmë përpjekjet tona që t'i njohim, t'i dëgjojmë dhe t'iu mundësojmë që të jenë pranë nesh, në momentet e veçanta festive, si dhe të mos hezitojmë të marrim pjesë kur ata na ftojnë. Ne, si të krishterë, s'duhet të kemi frikë prej njëri-tjetrit. Por, me ata që besojnë në Atin e gjithëpushtetshëm, në Krishtin një të vetmin Birin e Tij, në Shpirtin Shenjt, që e shpallin, Krishtin e Ringjallur, shpëtimtarin e botës, të kemi ndjenjën e vëllazërimit. Ndaj, bëni çmos që ta ruani njësinë e shpirtit me anë të paqes që ju bashkon. S'ka veçse një Trup të vetëm dhe një Shpirt të

vetëm - sikurse edhe jeni të grishur në një shpresë të vetme të thirrjes suaj. Nuk ka veçse një Zot, një fe, një pagëzim; një Hyj të vetëm, Atin e të gjithëve, i cili, sundon mbi të gjithë, vepron nëpër të gjithë e banon në të gjithë.⁶⁷

Prandaj, të gjithë duhet të gjejmë forma të reja miqësie, t'i pastrojmë burimit e dashurisë nga mbetjet e së kaluarës, në mënyrë që të rizbulojmë bukurinë e bashkimit dhe vëllazërisë, *“që të gjithë të jenë një. Sikurse ti, Atë, që je në mua dhe unë në ty, ashtu edhe ata të jenë në ne, që ta kuptojë bota se ti më dërgove.”*⁶⁸

85. Është pra mase e nevojshme, të përqendrohemi në tri veprime konkrete, të cilat janë të dobishme në bari-toren ekumenike të kishës tonë dhe të famullive tona:

- të mos mungojë lutja jonë për bashkimin e krishterëve dhe t'i ftojme të tjerët të na bashkohen në këtë lutje.
- katekeza, edukimi dhe formimi i besimtarëve të ketë këtë frymë pajtimi dhe dashurie, dhe
- të mos hezitohet askush që të kontribuojë në iniciativat e të tjerëve, që kanë këtë qëllim, qoftë edhe atëherë kur nuk pritet shumë përparim.

⁶⁷ Ef 4, 3-6.

⁶⁸ Gjn 17, 21.

Dialogu ndërfetar

86. Dialogu ndërfetar është dhe mbetet një përgjegjësi e të gjithëve. Realiteti jonë na shtytë që dialogu të jetë i përqëndruar në mes të krishterëve dhe myslimanëve. Për të dialoguar me islamin, thjeshtë, duhet ndjekur parimin e Gjon Pallit II *“të gjithë ne, të krishterë e mysliman, jetojmë nën diellin e mëshirës së një Hyji të vetëm”*⁶⁹ dhe atë të Papa Françeskut që *“të hapemi ndaj tjerëve, pa pas frikë që do humbim diçka nga e jona.”*⁷⁰ Realiteti ynë i dialogut me myslimanët, na mundëson të ngjitemi në një nivel më të lartë, pasi që këtij dialogu ne s’i qasemi vetëm nga konteksti fetar thjeshtë me myslimanë, por bashkëbisedojmë me vëllezërit tanë të një gjaku, me të cilët e kemi përballuar të kaluarën dhe duhet ta ndërtojmë të ardhmen. E me të cilët, përgjatë historisë, kishim edhe vlera të përbashkëta në fe, ndërsa sot, bashkëndajmë të njëjtat vlera qytetëruese, kulturore, shoqërore dhe kombëtare.

69 *Fjalimi i Gjon Pallit II para autoriteteve myslimane nigeriane*, Kaduna, (Nigeria), 14 shkurt 1982.

70 *Fjalimi i Papa Françeskut në takim me liderët e Bashkësive Fetare në Shqipëri*, Tiranë, 21 shtator 2014.

87. Duke qenë se dialogu ndërftetar, bashkëjetesa vëllazërore dhe toleranca ndërftetare herë pas here po vihet në diskutim, ne duhet të punojmë edhe më shumë në këtë drejtim, në mënyrë që të bëhemi kontribut pozitiv edhe në këtë kohë, ashtu siç kemi qenë në të kaluarën. Në mënyrë që të jemi në të vërtet një popull fisnik, siç na quan Papa Françesku.

88. Sot kemi tri grupe me të cilat duhet të zhvillojmë dialogun ndërftetar, me vëllëzërit tanë të islamizuar:

- *dialogun institucional me bashkësinë islame* dhe me segmentet e kësaj bashkësie, kudo në Kosovë, në mënyrë që së bashku të mund të promovojmë vlerat e trashëguara dhe bukurinë e bashkëjetesës ndërftetare.
- *dialogun personal, me ata të bijtë e popullit tonë*, të cilët na mirënjohin vlerat dhe kontributin tonë historik. Edhe pse s'na bashkohen në fe, së bashku me ta kemi përballuar të kaluarën, dhe janë të gatshëm që së bashku me ne ta ndërtojmë të ardhmen e vendit.
- *dialogu me grupet e riislamizuara* që i mohojnë vlerat e përbashkëta dhe angazhohen për islamizimin e kulturës, traditës dhe moralit kolektiv të kombit. Dialogu me ta është pjesa më e vështirë dhe më

sfiduese që na pret. Megjithatë, s'duhet të lodhemi duke u përpjekur për të gjetur gjuhën e dialogut edhe me ta.

89. Në angazhimin tonë për dialog, me cilindo grup, duhet të na prijnë parimet që i pata rreshtuar, në ligjëratën time mbi trashëgiminë kulturore me temën “*Pasuria e trashëguar dhe përgjegjësit tona në shërbim të së ardhmes*”. Këto parime, na ndihmojnë për të gjetur dallimin mes grupeve me të cilat duhet ushtruar dialogun ndërfaqetarak dhe për të ruajtur të pa cenuar identitetin tonë shpirtëror, kulturor e historik.⁷¹

71 Khs. Imzot Dodë Gjergji, *Pasuria e trashëguar dhe përgjegjësit tona në shërbim të së ardhmes*, Ligjëratë në tribunën “I krishteri dhe shoqëria”, Fondacioni “Drita”, Prishtinë 2014, ff. 28-31.

VIII. MJETET TJERA PËR UNGJILLIZIM

Trashëgimia kulturore

90. Trashëgimia kulturore është një privilegj për Kishën tonë, por edhe një mjet i fuqishëm në duar tona. Këndeje, pra, asnjëherë s'duhet lanë pas dore këtë fakt në jetën baritore të kishës. Duhet punuar me përkushtim që të gjejmë dhe të vejmë në pah, të gjithë pasurinë e rrënuar, e arkivuar dhe memorizuar në kujtesën e Kishës.

91. Kisha s'është një institucion kulturor, që duhet të merret me trashëgiminë apo promovimin e kulturës, por i përdorë ato, si dhurata për të pasuruar veten, dhe ia afron njeriut të sotëm si udhërrëfyes për të gjetur bukurinë e shpirtit të vetë. Ky mjet ungjillëzimi, duhet të përdorët duke botuar studime, organizuar seminare, konferenca, komunikim dhe debat publik, sidomos nëpërmjet mediave të komunikimit masiv.

Në këtë drejtim, sigurisht na mungon mbështetja, si dhe mundësitë tona janë të limituara, prandaj lypset që të jemi të kujdesshëm dhe këto pasuri t'i përdorim me urti.

92. Baritorja kulturore, duhet të ketë për qëllim ruajtjen e saj, si dhe të ndihmojë përforcimin e fesë së të pagëzuarave. Njëkohësisht duhet të shërbejë si udhërrëfyes për ata që janë në kërkim të kthimit “në fenë e të parëve” dhe të ndihmojë dialogun ndërftuar ndër ne. Trashëgimia kulturore, traditat pozitive, sidomos trashëgimia gjuhësore, duhet të shërbejnë për çdo shqiptar si “*pasqyrë*” në të cilën ne njohim vetën tonë.

93. Mbi të gjitha, duhet të jemi të vendosur që këto pasuri që i përfaqësojmë; sidomos kur i përdorim si mjet ungjillëzimi, të mos na prijë krenaria e mburrja, por përvujtëria dhe dashuria, sepse vetëm kështu mund të jemi të dobishëm për vete dhe për të tjerët.

Mjetet e komunikimit masiv

94. Fjala, *zani*, shkrimi, piktura dhe fotografia, janë mjete nëpërmjet të cilave Kisha, gjithnjë duke iu për-

shtatë kohës, është përpjekë të çojë Lajmin e Mirë të Ungjillit të të gjithë njerëzit.

Edhe kisha jonë i ka përdorë të gjitha këto mjete, por më shumë për ta ruajtur sesa për të përçar porosinë Ungjillore. Këndej, këto gjurmë i kemi shkrimet dhe librat e para në gjuhën shqipe, *Formulën e Pagëzimit, Mesharin, Çetën e Profetëve* dhe shumë e shumë të tjera deri në kohën e stome.

Kisha jonë në Kosovë, ka pasur disa fletushka dhe revistën *Drita*, nëpërmjet së cilës është përpjekur të përçojë vlerat fetare, kulturore dhe shoqërore të të gjithë njerëzit vullnetmirë. Mund të themi se mjetet e komunikimit masiv s'kanë munguar asnjëherë në misionin e Kishës për ta shpallë Ungjillin.

95. Në fillim shekullin e XXI, kemi hyrë në një epokë të re të komunikimit masiv, ku secili nga shtëpia e vet, mund të komunikojnë me shumë njerëz, duke përçarur te ta, mendimin, figurën, zërin me pakë fjalë, *virtua-lisht*, veten e tyre. Në këtë mundësi komunikimi, janë përfshirë edhe ipeshkvij, meshtarë, murgësia dhe besimtarë, të cilët, përpiqen t'i shfrytëzojnë këto mundësi për të përçarur fenë, për të shpallur Krishtin dhe për të bashkëndarë lutjet e veta me të tjerët.

96. Çdo mundësi që na i jep Zoti, sikurse edhe Interneti, duhet të përdoret në shërbim të misionit që kemi marrë prej atij që na ka thirrur. Mirëpo, punëtorët e vreshtit të Zotit, duhet të kenë kujdes që puna e tyre të jetë e dobishme për *shenjtërimin e njerëzve* dhe frytdhënëse për *mbretërinë e qiellit*. Për t'iu përgjigjur nevojave të njeriut të sotëm, dhe për të shfrytëzuar sa më mirë këto mjete të reja të komunikimit masiv, nevojitet që të kemi kujdes të veçantë dhe t'i përdorim me përgjegjësi edhe njohuri të mjaftueshme.

97. Është mirë që në nivelin dioqezan, të ngritet një komision i veçantë, i cili, do të na ndihmojë të gjithëve që të përdorim këto mundësi, *sa më shumë e sa më mirë*, në dobi të ungjillëzimit të ri dhe të ri-ungjillëzimit të ne.

*Ungjillëzimi nëpërmjet
bashkëpërgjegjësisë shoqërore*

98. Kisha është e vetëdijshme se nuk është e vetme në botë dhe që të përkohshmen e bashkëndan me një shoqëri, e cila, në vete bartë pluralizmin e vlera-

ve, ndërrueshmërinë e feve, dallimin e kulturave dhe shumësinë e traditave.

Ajo po ashtu është e vetëdijshme se jeton dhe shpallë Ungjillin, brenda përmasave të një kulture - një qytetërimi; brenda rrethanave të një bashkësie politike, që ne e quajmë shtet. Kisha ka parasysh gjithnjë kontekstin socio-ekonomik, gjendjen reale të vuajtjeve të njerëzve dhe përparimit të tyre brenda shoqërisë ku jetën. Ajo, brenda një shoqërie të caktuar, nga natyra e saj, ka përgjegjësi që të promovojë paqen, pajtimin mes njerëzve; të thërras ndërgjegjen e shoqërisë, që të jetë e drejtë, të ketë kujdesin e nevojshëm për shtresat në nevojë dhe të shpërndajë të mirat e përbashkëta, në mënyrë të barabartë, ashtu që askush të mos jetë i privuar nga e drejta për të dhanë kontributin personal për të mirën e të gjithëve; dhe askujt të mos i mohohet pjesëmarrja në këto të mira. Përgjegjësia e Kishës është që të jetë “zëri” i të varfërve, i të mjerëve, i jetimëve dhe i të gjithë atyre që s’munden të flasin. Asnjë shoqëri s’duhet t’ia mohojë Kishës detyrat që ajo ka brenda një shoqërie, s’mund t’i mohohet e drejta që të jetë pjesëmarrëse në përparimin e shoqërisë, por as të drejtën për të qortuar kur i shkelë të drejtat universale, përbuzë dinjitetin njerëzor, keqpërdorë të mirat

e përbashkëta, kur zhvlerëson vlerat universale ose shkel ligjet natyrore.

99. Kisha ndër ne gjithnjë ka qenë e vetëdijshme për rrethanat historike dhe për nevojën e përgjithshme të kombit, këndeje pra, asnjëherë s'ka hezituuar t'i përdorë, t'i marrë përgjegjësitë e veta shoqërore dhe as t'i ushtrojë të drejtat themelore që i përmenda më sipër. Në shumë rrethana ka qenë bashkëbartëse e realiteti shoqëror. Madje, shpeshherë ka prirë në marrjen e përgjegjësiave për të mirën e përbashkët të shoqërisë. Prandaj, sot, ajo gëzon respektin e shumicës së qytetarëve në Kosovë.

100. Të krishterët katolikë, së bashku me kishën e tyre dhe kisha e bashkuar me besimtarët e vetë, duhet të dijë të lexojë përgjegjësitë në këtë kohë dhe në këtë vende. Kjo e bënë që të jetë bashkëbartëse e përgjegjësiave brenda shoqërisë për kujdesin ndaj njerëzve në nevojë, duke iu dhuruar atyre mundësitë e veta edhe shpirtin e dashurisë që ka për ta. Mbi gjitha, kjo përgjegjësi bie mbi *Caritasin*, që është kryekëput në këtë shërbim. Çdo punëtor në *Caritas*, edhe ata që s'janë të pagëzuar, duhet t'i udhëheq e njëjta frymë e përgjegjësiave në kryerjen e detyrave të tyre.

101. Institucionet e Kishës Katolike në Kosovë, dhe të gjithë ata që i drejtojnë ato, duhet të jenë të përgjegjshëm, në bartjen e përgjegjësive që kanë ndaj krejt shoqërisë. Sikur janë: ruajtja e trashëgimisë së përbashkët shpirtërore, qartësia e identitetit kulturor dhe etnik, shërimi i plagëve të urrejtjes nëpërmjet promovimit të faljes, pajtimit, drejtësisë dhe paqes me gjithë qytetarët e vendit.

102. Mjet i fortë i ungjillëzimit në duart e besimtarëve është *përgjegjësia qytetare*, nëpërmjet respektimit të të drejtave e të gjithëve dhe ligjeve pozitive të shtetit. Një mundësi të veçantë e kanë ata besimtarë që kanë detyra shoqërore dhe përgjegjësi politike, të cilët, duke qenë të ndershëm me shembullin e jetës; të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave, të pa korruptueshëm në zbatimin e ligjeve, dhe të pa kompromis në ruajtjen e integritetit shpirtëror dëshmojnë vlerën dhe kuptimin e Ungjillit e bëhen shembull për gjithë shoqërinë. Cilat janë përgjegjësit shoqërore të besimtarëve dhe të Kishës, sigurisht mund t'i gjemë gjerësisht në përmbledhjen e mësimin shoqërorë të kishës.⁷²

72 I gjithë ky kapitull ka për bazë Dokumentet e Koncilit II të Vatikanit dhe Përmbledhjen e Doktrinës Shoqërore të Kishës. Të dyja këto libra janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe janë në disponim të të gjithëve.

PËRMBLEDHJA

103. Është në vullnetin tim si bari që të falënderojmë Hyjin për dhuratat të cilat i kemi marrë gjatë bashkëungjillëzimit gjatë këtyre viteve, prej kur kam ardhur ndër ju, si bari. Mirëpo, edhe që t'iu ftoj të vazhdojmë këtë bashkëdarje të përgjegjësive ungjillore dhe kishtare, në udhëtimin tonë në pesëvjeçarin e ardhshëm.

Me gjithë zemër dëshiroj që ky dokument të jetë një mjet, i cili, do të na ndihmojë të gjithëve gjatë udhëtimit tonë të përbashkët, në pesëvjeçarin e ardhshëm. Pres me shpresë, që misioni ynë, për t'iu shpallur të gjithëve Ungjillin e Krishtit, të arrijë suksese të shumta. Mbi të gjitha, shpresoj që në këtë mision, do të kemi mbështetje të madhe dëshminë e atyre që janë pagëzuar dhe që do të pagëzohen në të ardhmen.

Është detyrë e jona që të reformojmë mendësitë dhe shpirtin tonë, në mënyrë që të kemi një kishë, e cila, di t'iu përgjigjet rrethanave të reja me qasje të re, në të gjitha sferat e jetës dhe veprimit. Sidomos, duke krijuar kushte dhe hapësira të reja për besimtarin laik, që edhe ai të jetë pjesë e misionit dhe e përgjegjësive,

dhe jo vetëm konsumues i të mirave shpirtërore për vete dhe familjen e tij dhe kontribuues i të mirave të përkohshme për priftin dhe nevojat e kishës.

104. Të gjithë duhet të punojmë, pa përtesë dhe me shumë zell ungjillor, që Kisha shtëpi, kisha famulli dhe kisha ipeshkvi, të jetë kishë e gjallë, që pajton e shenjtëron të gjithë. Për të shpallë Ungjillin, përdorë mjetet e nevojshme: me urti, me duresë e me guxim, si dhe për t'iu përgjigjur nevojave të reja, është e gatshme të reformohet, duke rinuar vetveten, në përkim me nevojat e reja të njerëzve.

105. Ndryshimet të cilat kërkohen në këtë plan baritor, janë sfidë, por duhet t'i arrijmë me duresë, me dashuri, si dhe duhet kuptuar jo si ndryshim burimi, por si pastrim i burimit të vjetër, që të na jep ujin e kthjellët e të bollshëm për nevojat që ka njeriu dhe kisha sot.

106. Uroj që vit pas viti, të arrijmë të zbatojmë, këtë plan baritor, në gjitha kërkesat që ka, dhe do të kemi mundësi t'iu gëzohemi fryteve të punës sonë të përbashkët.

Përmbajtja

I. KISHË NË PUNË DHE NË FALENDERIM	8
<i>“Po a nuk na ndizej zemra neve ndërsa po bisedonte udhës me ne [...]?”</i>	<i>8</i>
<i>Punëtorë të vyeshëm në vreshtin e Hyjit.....</i>	<i>12</i>
<i>Ejani të shkojmë ku jemi thirrur e të dërguar.....</i>	<i>16</i>
II. FRYTET E UNGJILLËZIMIT NDËR NE	20
<i>“Me Jezu Krishtin gjithmonë lindë dhe rilindë gëzimi”</i>	<i>23</i>
<i>Ta bartim gëzimin ungjillor tek të gjithë njerëzit</i>	<i>26</i>
III. KISHË QË E PRINË SHPIRTI SHENJT	31
<i>“Rrini zgjuar dhe lutuni të mos bini në tundim”</i>	<i>31</i>
<i>Të frymëzuar nga Shkrimi i Shenjtë.....</i>	<i>33</i>
<i>Të zbresim pak më poshtë që të ngjitemi pak më lartë</i>	<i>35</i>
<i>Bashkëpërgjegjës në Kishë.....</i>	<i>37</i>
<i>Baritorja thirrëre</i>	<i>40</i>
<i>Edhe besimtarët laikë janë të thirrur.....</i>	<i>41</i>
IV. FAMILJA - BASHKËSI FEJE	45
<i>Për t'i kthyer zemrat e etërve kah fëmijët.....</i>	<i>45</i>

V. KISHA FAMULLITARE - VOTËR SHPIRTËRORE E BESIMTARIT	56
<i>Me një shpirt e me një zemër të vetme</i>	<i>56</i>
<i>Por gjithmonë bëni të përparojë e mira ndër ju...!</i>	<i>60</i>
<i>Famullitari - Atë shpirtëror i të gjithëve!</i>	<i>62</i>
<i>Famullia - shtëpi e përbashkët ku të gjithë kanë përgjegjësi</i>	<i>64</i>
<i>Rrjeti bashkëpunues i famullive.....</i>	<i>69</i>
VI. KATEKEZA - SHKOLLË E FESË	70
<i>Të ftuar për të kumtuar Ungjillin e Krishtit.....</i>	<i>70</i>
<i>Udhëzimet kryesore për mësimin e fesë.....</i>	<i>72</i>
VII. VEPRA MISIONARE NË REALITETIN TONË	79
<i>Vëllezër me të gjithë</i>	<i>79</i>
<i>Që të gjithë të jenë një</i>	<i>80</i>
<i>Dialogu ndërftar</i>	<i>83</i>
VIII. MJETET TJERA PËR UNGJILLIZIM.....	86
<i>Trashëgimia kulturore.....</i>	<i>86</i>
<i>Mjetet e komunikimit masiv.....</i>	<i>87</i>
<i>Ungjillëzimi nëpërmjet bashkëpërgjegjësish shoqërore</i>	<i>89</i>
PËRMBLEDHJA.....	93

